

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5988
E mërkurë, 29 janar 2020
çmimi 0.40 €

Rritet për 50 për qind tentimi për thyerjen e llogarive bankare



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

LËVIZJA VETËVENDOSJE DHE LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS KANË
ZHVILLUAR TAKIM ME AMBASADORËT E VENDEVE TË QUINTIT

S'KA MARRËVESHJE

LV - LDK



Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk i ka ndihmuar as takimi i së martës me ambasadorët e vendeve të Quintit që të bëjnë marrëveshje për bashkëqeverisje. Pas takimit, liderët e të dy partive, Albin Kurti dhe Isa Mustafa, kanë bërë me dije se nuk ka përafirim të qëndrimeve. Ata kanë fajësuar njëri-tjetrin për mosarritje të marrëveshjes. Ndërsa që të dy kanë treguar se ambasadorët e Qunitit në këtë takim nuk kanë ndërmjetësuar, por janë informuar për procesin



OPINION

ADN-JA E FUSHAVE MAGNETIKE DHE ANTIMAGNETIKE

Shkruan: Naim
KRASNIQI, fizikan



AKTUALE

NË UROLOGJI KRYHET NJË OPERACION I KOMPLIKUAR

RASTI "VETERANËT", MBETET I PAQARTË NUMRI I PËRFITUESVE TË PENSIONIT



EKONOMI

BIZNESET KANË SHUMË PROBLEME PËR ZHVILLIMIN E TYRE

KARTËMONEDHA PREJ 100 EUROSH, MË E FALSIFIKUARA NË TREGUN E KOSOVËS



KULTURË

VI. KONTRIBUTET NË FUSHË TË HISTORISË

Prof. asoc. dr. Myrvete Dreshaj-BALIU
Prof. dr. Begzad BALIU

PRESIDENTI I SHQIPËRISË I SHKRUAN LETËR URIMI BOTUESIT MAVRAJ PËR 20-VJETORIN E 'EPOKËS SË RE'



Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, i ka dërguar një letër urimi botuesit Muhamet Mavraj në 20-vjetorin e themelimit të gazetës "Epoka e re". Meta ka uruar Mavrajn dhe stafin e gazetës për këtë jubile, duke theksuar se "Epoka e re", si zëdhënëse kurajoze e fjalës së lirë, interesit publik dhe kombëtar, vazhdon të japë kontribut cilësor për informimin e drejtë dhe çështjen shqiptare, veçanërisht për forcimin dhe mirëfunksionimin e demokracisë dhe institucioneve të shtetit të së drejtës në Kosovë

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

WE

Women in Energy

Gratë në Energji
Programi i Punës Praktike

Për të gjitha detajet:
[millenniumkosovo.org/
womeninenergy](http://millenniumkosovo.org/womeninenergy)

**Thirrje për
shprehje të
interesit nga gra
të interesuara
për punë
praktike
profesionale
(me pagesë)
në sektorin e
energjisë në
Kosovë.**

Fondacioni i Mijëvjeçarit të Kosovës (MFK) është në prag të fillimit të programit: Punë praktike me pagesë për gratë në kuadër të projektit "Gratë në Energji". Qëllimi i këtij programi është të mbështesë punësimin e rreth 200 grave në sektorin e energjisë përmes ngritjes së kapaciteteve të nevojshme profesionale të grave duke ju ofruar atyre përvojë në punë praktike me pagesë në institucionet publike, entitetet private, organizata jo-qeveritare dhe organizata ndërkombëtare që janë pjesë e sektorit të energjisë në Kosovë.

Të gjitha gratë që janë:

- (1) studente të nivelit Master,
- (2) studente në vitin e fundit të studimeve Bachelor dhe (3) studente të diplomuara në tre vitet e fundit por të papunësuar mund të aplikojnë për punë praktike. Puna do të zgjasë jo më shumë se gjashtë muaj dhe të punësuarat do të kenë mundësi të fitojnë eksperiencë pune në sektorin e energjisë në Kosovë duke u mentoruar dhe vlerësuar nga profesionistë të fushës.

Fushat e studimit të pranueshme për puna praktike janë:

- STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë),
- Menaxhimi i projektit,
- Marketingu dhe financat,
- Ekonomia,
- Juridiku,
- Teknologjia e informacionit, dhe
- Disiplina të tjera të rëndësishme për sektorin e energjisë.

Nëse jeni e interesuar për tu bërë pjesë e këtij programi, ju lutem vizitoni websajtin tonë dhe plotësoni formën: Formë Kontakti për Praktikante Potenciale

millenniumkosovo.org/womeninenergy



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**



MILLENNIUM
CHALLENGE CORPORATION
UNITED STATES OF AMERICA

Gratë në Energji / Programi i Punës Praktike

Gjukanoviqi: Ideja e Serbisë së Madhe është sërish në tavolinë

PODGORICË, 28 JANAR - Presidenti i Mali të Zi, Milo Gjukanoviqi, gjatë një takimi me strukturat e Partisë Socialiste Demokratike në qytetin e Tivarit ka lëshuar deklarata të forta për qasjen nacionaliste të Serbisë në rajon. Duke folur për politikën aktuale serbe, presidenti malazias ka veçuar ëndrrat ekspansioniste në kurriz të fqinjëve në të kaluarën dhe në vazhdim. Por, ai ka paralajmëruar se ky plan që vazhdon

që nga vitet '90 nuk mund të bëjë as një Serbi të madhe e as një Shqipëri të madhe, por veç një tragjedi të madhe, njofton B92. "Ky është një plan që ka qenë përherë në sirtar që në vitet '90 dhe ka kushtuar kaq shumë jetë për rajonin tonë. Prandaj nuk mund të ketë as Serbi të madhe, as Shqipëri të madhe, por vetëm një tragjedi të madhe. Në vend se të mësonin këto mësimet të '90-ës, siç shohim 30 vjet më pas,

idetë e vjetra po rikthehen në tavolinë dhe pjesë integrale e këtyre ideve është nacionalizmi pas idesë së Serbisë së madhe që duke përdorur Kishën Ortodokse përpiqet të përfaqësojë Malin e Zi, të ndikojë jetën në Malin e Zi. Është diçka me të cilën ne nuk biem dakord dhe ndaj së cilës po tregojmë rezistencë të vendosur dhe që ne nuk do të lejojmë të ndodhë ndonjëherë në Mal të Zi", deklaroi Gjukanoviqi.



Zgjidhja e Trumpit për konfliktin mes Izraelit dhe Palestinës

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, gjatë një takimi në Shtëpinë e Bardhë me kryeministrin e Izraelit, Benjamin Netanyahu, publikoi të martën planin e tij të paqes mes Izraelit dhe Palestinës



UASHINGTON, 28 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, publikoi të martën planin e paqes mes Izraelit dhe Palestinës, gjatë një takimi në Shtëpinë e Bardhë me kryeministrin e Izraelit, Benjamin Netanyahu. Plani është rezultat i një pune trevjeçare të këshilltarit të lartë të presidentit Jared Kushner, i cili është njëkohësisht edhe dhëndri i Trumpit. Përpara njoftimit të planit për paqe në Lindjen e Mesme,

Trumpi ka zhvilluar takime me Netanyahu dhe udhëheqësin e opozitës izraelite Benny Gantz për t'i njohur ata me përmbajtjen e tij. Netanyahu e ka cilësuar planin si "mundësia e shekullit që nuk duhet humbur". Gantz e quajti atë një "moment historik të rëndësishëm". Një zëdhënës i Netanyahu tha se kryeministri izraelit do të nisej drejt Moskës sot (e mërkurë) për ta njohur presidentin rus Vladimir Putin mbi propozimin.

Ndërkohë të martën me mijëra palestinezë demonstruan kundër planit amerikan, disa orë përpara publikimit të tij në një ceremoni në Uashington. Ndërsa udhëheqësit izraelitë e kanë mirëpritur planin, udhëheqësit palestinezë e kanë kundër-

shtuar atë edhe pse nuk është bërë ende publik. Ata thonë se administrata e Trumpit është e njëanshme, pro Izraelit. Palestinezët frikësohen se plani i Trumpit do t'i shuajë shpresat që ata kanë për një shtet të pavarur në Bregun Perëndimor, në Gazë

dhe në lindje të Jerusalemit. Ndërkohë të martën ndaj Netanyahu është ngritur një padi zyrtare në gjykatë lidhur me akuza për korrupsion, një zhvillim që pasoi vendimin e kryeministrit izraelit për të hequr dorë nga një kërkesë e tij për të kërkuar imunitet parlamentar nga ndjekja penale. Ai tha përmes një deklaratë të bërë publike në rrjetin social "Facebook", se "vendosi të mos lejojë që kjo lojë e ndyrë të vazhdojë".

Netanyahu ka mohuar akuzat dhe ai nuk ka asnjë detyrim ligjor të japë dorëheqjen. Partia Likud e Netanyahu po planifikonte ta bojkotonte seancën e së martës në Knesset. Ai është akuzuar për mashtrim, shkelje të besimit dhe rryshfet në tri raste të ndara.

Nagavci, Krasniqi e Damka marrin pjesë në Sesionin e Parë të AP të Këshillit të Evropës

PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në përbërje të tre nënkryetarëve: Arbërie Nagavci, kryesuese e delegacionit, si dhe Memli Krasniqi e Fikrim Damka, anëtarë të delegacionit, të shoqëruar nga ambasadorja Mimoza Ahmetaj, po marrin pjesë në punimet e Sesionit të Parë të Rregullt të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës - APiKE, për vitin 2020,



që po mbahen në Strasburg të Francës, nga 26 - 31 janar 2020.

Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës ka marrë

pjesë edhe në takimet e Komiteteve Parlamentare të APiKE-së, atë të Komitetit për Çështje Politike dhe Demokraci, Komitetit për Çështje Ligjore dhe të Drejtat të Njeriut, si dhe Komitetit për Çështje Sociale, Shëndetësi dhe Zhvillim të Qëndrueshëm. Po ashtu, delegacioni ka marrë pjesë edhe në mbledhjet e grupeve politike të APiKE-së. Delegacioni i Kuvendit të Kosovës ka zhvilluar takime

bilaterale me anëtarë të delegacioneve pranë APiKE-së, përfshirë edhe përfaqësues të delegacionit gjerman, në përbërje: Peter Beyer nga koalicioni CDU-CSU, njëherësh raportues për Kosovën në KiE, si dhe Axel Schafer nga Partia Social Demokratike. Në takim u kërkuar përkrahja e Gjermanisë për anëtarësimin e Kosovës në KiE si dhe mbështetja në procesin e integritimit evropian.

Kim: Ndhimë teknike për zbatimin e reformës në drejtësi

TIRANË, 28 JANAR - Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara në Tiranë, Yuri Kim, zhvilloi të martën takime prezantuese me ministrin në detyrë të Punëve Evropiane dhe të Jashtme, Gent

Cakaj, ministren e Mbrojtjes Olta Xhaçka dhe ministren e Drejtësisë, Etilda Gjonaj. Gjatë takimeve, ambasadorja Kim shprehu vlerësimin e thellë të Shteteve të Bashkuara për

kontributet e Shqipërisë si një aleate e NATO-s dhe mbështetjen e saj të rëndësishme në misionet tona të përbashkëta. Ambasadorja gjithashtu rikonfirmoi angazhimin e Shteteve të

Bashkuara në ndihmë teknike për zbatimin e reformës në drejtësi dhe premtoi mbështetje të vazhdueshme për rrugën e Shqipërisë drejt anëtarësimin në Bashkimin Evropian.



Presidenti i Shqipërisë i shkruan letër urimi botuesit Mavraj për 20-vjetorin e 'Epokës së re'

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, i ka dërguar një letër urimi botuesit Muhamet Mavraj në 20-vjetorin e themelimit të gazetës "Epoka e re". Meta ka uruar Mavrajn dhe stafin e gazetës për këtë jubile, duke theksuar se "Epoka e re", si zëdhënëse kurajoze e fjalës së lirë, interesit publik dhe kombëtar, vazhdon të japë kontribut cilësor për informimin e drejtë dhe çështjen shqiptare, veçanërisht për forcimin dhe mirëfunksionimin e demokracisë dhe institucioneve të shtetit të së drejtës në Kosovë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

Tiranë, më 28 janar 2020

I nderuar Zoti Mavraj,

Me rastin e 20-vjetorit të themelimit të gazetës "Epoka e Re", dëshiroj t'ju shpreh urimet më të përzemërta, ju, të gjithë gazetarëve dhe drejtuesve të saj në vite.

"Epoka e Re", si zëdhënëse kurajoze e fjalës së lirë, interesit publik dhe kombëtar, vazhdon të japë një kontribut cilësor për informimin e drejtë dhe çështjen shqiptare, veçanërisht për forcimin dhe mirëfunksionimin e demokracisë dhe institucioneve të shtetit të së drejtës në Kosovë.

Duke ju falënderuar për ftesën Tuaj, dhe në pamundësi për të marrë pjesë në ceremoninë festive të këtij jubileu, i uroj jetë të gjatë në tregun mediatik shqiptar "Epokës së Re" dhe më shumë suksese në misionin e saj fisnik!

Me respekt,
Ilir Meta

Zotit Muhamet Mavraj
Botues i gazetës "Epoka e Re"
PRISHTINË, KOSOVË



PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka uruar të martën botuesin Muhamet Mavraj për 20-vjetorin e themelimit të gazetës "Epoka e re".

Presidenti Meta, në letrën dërguar Mavrajt, ka thënë se "Epoka e re", si zëdhënëse kurajoze e fjalës së lirë, interesit

publik dhe kombëtar, vazhdon të japë një kontribut cilësor për informimin e drejtë dhe çështjen shqiptare, veçanërisht për forcimin dhe mirëfunksionimin e demokracisë dhe institucioneve të shtetit të së drejtës në Kosovë. "Me rastin e 20-vjetorit të themelimit të gazetës 'Epoka e re', dëshiroj t'ju shpreh urimet më të

përzemërta, ju të gjithë gazetarëve dhe drejtuesve të saj në vite. 'Epoka e re', si zëdhënëse kurajoze e fjalës së lirë, interesit publik dhe kombëtar, vazhdon të japë një kontribut cilësor për informimin e drejtë dhe çështjen shqiptare, veçanërisht për forcimin dhe mirëfunksionimin e demokracisë dhe institucioneve

të shtetit të së drejtës në Kosovë. Duke ju falënderuar për ftesën Tuaj, dhe në pamundësi për të marrë pjesë në ceremoninë festive të këtij jubileu, i uroj jetë të gjatë në tregun mediatik shqiptar 'Epokës së re' dhe më shumë suksese në misionin e saj fisnik", ka shkruar presidenti Meta në letrën e tij drejtuar botuesit të

gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj.

Ky i fundit, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ku ka shpërndarë letërrurimin e presidentit Meta, e ka falënderuar atë për urimin. "Na nderove, President! Ndiej në zemër respekt suprem nga shenja e Shqipërisë!", ka shkruar Muhamet Mavraj.

Hamza: Konjufca duhet të japë dorëheqje

PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Shefi i Grupit Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, në një konferencë për media të mbajtur të martën në selinë e kësaj partie, ka folur për të dënuarit e 'Syrin të popullit' dhe mosreagimin e Lëvizjes Vetëvendosje për këtë rast. Ai ka thënë se është shqetësuese që ideologët e organizatës 'Syrin të popullit' nga Vetëvendosja nuk kanë bërë asnjë distancim nga kjo organizatë. "Për Partinë Demokratike të Kosovës është e papranueshme qasja e deritanishme e Vetëvendosjes e cila po pretendon t'i udhëheqë institucionet e vendit. Akoma më

alarmante është mosdeklarimi për këtë çështje i kryetarit të Kuvendit të Kosovës që vjen nga kjo parti, Glauk Konjufcës, i cili është një nga ideologët politikë të kësaj organizate terroriste. Si mbajtësi i njëjës prej pozitave më të rëndësishme të shtetit të Kosovës ai ka detyrim moral dhe institucional që ta sqaroj opinionin publik për implikimin e tij personal me këtë organizatë kur dihet për më tepër se ai është edhe i lidhur ngushtë familjarisht me njërin nga protagonistët e kësaj organizate terroriste, Sadri Ramabajën, ish-kandidatin për deputet dhe ish-asamblistin e Lëvizjes Vetëvendosje", ka thënë



Hamza. Ai ka theksuar se 20 vjet pas luftës Kosova nuk e meriton të ketë në krye të institucionit kryesor demokratik një politikan i cili ka

lidhje familjare dhe politike me aktivistët e Vetëvendosjes të "Syrin të popullit". "Tanimë që aktakuza është provuar dhe aktivistë të Vetëvendosjes si Sadri Ramabaja

tashmë janë dënuar, është bërë e domosdoshme që Lëvizja Vetëvendosje të reagojë duke u distancuar nga kjo organizatë terroriste dhe duke dënuar veprimtarinë e saj. Për këtë arsye, kryeparlamentari Glauk Konjufca duhet urgjentisht të japë dorëheqje që ta ruajë karakterin demokratik dhe ligjor të Kuvendit të Kosovës. Heshtja e vazhduar e Lëvizjes Vetëvendosje nuk bën gjë tjetër përveçse legjitimon aktet terroriste të kësaj organizate dhe vërteton lidhjet e ngushta politike dhe familjare mes Syrinit të Popullit dhe Vetëvendosjes", ka deklaruar Hamza.

Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës kanë zhvilluar takim me ambasadorët e vendeve të Quintit

S'ka marrëveshje

Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk i ka ndihmuar as takimi i së martës me ambasadorët e vendeve të Quintit që të bëjnë marrëveshje për bashkëqeverisje. Pas takimit, liderët e të dy partive, Albin Kurti dhe Isa Mustafa, kanë bërë me dije se nuk ka përafrim të qëndrimeve. Ata kanë fajësuar njëri-tjetrin për mosarritje të marrëveshjes. Ndërsa që të dy kanë treguar se ambasadorët e Quintit në këtë takim nuk kanë ndërmjetësuar, por janë informuar për procesin

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 28 JANAR - As takimi prej disaorësh me ambasadorët e vendeve të Quintit dhe shefen e Zyrës së BE-së në Prishtinë nuk i ka ndihmuar Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës që ta arrijnë marrëveshjen për koalicionin qeverisës. Pas takimit, palët kanë fajësuar njëri-tjetrin për mosarritjen e marrëveshjes. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, i nominuar për kryeministër të Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se gatishmëria e tij për marrëveshje ka qenë e madhe. Por, sipas tij, marrëveshje nuk bëhet njëanshëm. "Populli e ka thënë fjalën e vet. Interesimi dhe gatishmëria ime ka qenë shumë e madhe. Na ka ngelur vetëm një javë kohë. Pa rezerva dhe me punë të palodhshme kam qenë i hapur për marrëveshje, por nuk mund të ketë marrëveshje me përafrim të njëanshëm. Për koalicion, afrimi duhet të jetë i dyanshëm", ka thënë Kurti para mediave. Ai ka deklaruar se nuk ka marrëveshje me LDK-në sepse ajo po shkon vetëm me versionin e vet. "LDK-ja po shkon me opsionin 'merre ose lëre', që do të thotë lëre", është shprehur Kurti.

Ndërsa lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se zgjidhja që e ka ofruar LDK-ja është më e mira. "Ne biseduam me Lëvizjen Vetëvendosje për mundësinë e koalicionit qeverisës, i informuam edhe ambasadorët e Quintit, sepse ardhja e tyre kishte për qëllim të informohen dhe jo të ndërmjetësojmë dhe të ndikojnë në procesin e marrëveshjes. Si LDK ne jemi të bindur se zgjidhja të cilën e kemi ofruar kohën e fundit është një zgjidhje që i kontribuon marrëveshjes qeverisëse, e cila balancon marrëveshjen mbi suazat e votës dhe besimit qytetar që kemi marrë në zgjedhje e tetorit të vitit të kaluar", ka thënë Mustafa, duke shtuar se LDK-ja është e gatshme për marrëveshje në çdo çast që i përmbushen kushtet e saj. "U shprehëm se mbesim të hapur nëse LV-ja, si parti e parë, i pranon kushtet tona për

bashkëqeverisje. Ne jemi të gatshëm në çdo çast të lidhim marrëveshje për bashkëqeverisje. Konsiderojmë se do të jetë një marrëveshje që i kontribuon vendit, luftës kundër krimit dhe korrupsionit, i kontribuon zhvillimit ekonomik dhe jep përgjigje në besimin qytetar që ne kemi marrë", ka deklaruar Mustafa.

Në takimin e Kurtit dhe Mustafës të martën kanë marrë pjesë shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Natalya Apostolova, ambasadori i Gjermanisë, Christian Held, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, Nicholas Abbott, si dhe përfaqësues të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Francës dhe të Ambasadës së Italisë në Prishtinë.

Gjatë ditës shtetet e Quintit kanë sqaruar se nuk ndërhyjnë në formimin e qeverisë.

Përmes një komunikatë të përbashkët për medie shtetet e Quintit kanë vlerësuar se nuk përkrahin asnjë parti apo kandidat, kushdo qoftë ai. "Në prag të spekulimeve të fundit ne do të donim ta sqaronim qëndrimin tonë në lidhje me procesin e formimit të Qeverisë në Kosovë. Siç është cekur në deklaratën tonë të 30 gushtit 2019, ne përfaqësojmë shtetet që janë thellësisht të përkushtuara ndaj Kosovës demokratike dhe të pavarur. Çdo sugjerim se qeveritë tona përkrahin ndonjë parti apo kandidat të veçantë në zgjedhje është i pasaktë... përgjegjësia për të ardhmen e Kosovës, për udhëheqësit e Kosovës, dhe për vetë Kosovën, është vetëm e juaja, e popullit të Kosovës. Ne nuk do të ndërmjetësojmë. Ne i inkurajojmë të gjithë aktorët politikë në Kosovë që të përqendrohen në aspiratat e popullit të Kosovës", është thënë në komunikatën e vendeve të Quintit.

Kritikohet ftesa për ambasadorët

Përfaqësuesit e partive opozitare dhe njohësit e rrethanave politike e kanë kritikuar ftesën e LV-së që në takimin e të martës me LDK-në të marrin pjesë edhe

ambasadorët e vendeve të Quintit dhe shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë. Kryetari i Partisë Socialdemokrate, Dardan Molliqaj, ka deklaruar se LV-ja çdoherë ka kundërshtuar ashpër ndërhyrjen e ndërkombëtarëve në krijimin e institucioneve të Kosovës pas zgjedhjeve demokratike. "Duke hequr dorë nga parimet e qëndrimit, duke përdorur çdo metodë për të arritur në pushtet të cilën e ka kritikuar më herët, LV po shndërrohet në parti nga e cila shpresa e ndryshimi mund të pritët aq sa mund të pritët nga partitë që deri tani kanë qenë në pushtet", ka shkruar Molliqaj në profilin e vet në "Facebook". Ai ka thënë LV-ja kishte krijuar dhe formësuar kritikën ndaj ndërhyrjes së ndërkombëtarëve në proceset e shtetndërtimit. "Por, LV-ja dita-ditës po transformohet në një parti tipike të Kosovës, e cila përdor shantazhin, gënjeshtren për premtime elektorale, ndryshimin e parimeve për çështje mbi të cilat i ka kritikuar gjatë historikut të saj dhe heshtjen përballë dy marrëveshjeve me Serbinë ku Kosova as nuk po përfaqësohet nga institucionet e saj", ka shkruar ai.

Edhe nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ali Berisha, ka thënë se gjithmonë nga LV-ja është proklamuar se ndërhyrjet ndërkombëtare nuk duhet të jenë bazë për themelimin e institucioneve apo qeverisë. "Kjo që është proklamuar përpara që ndërhyrjet ndërkombëtare nuk duhet të jenë bazë për themelimin e institucioneve apo qeverisë, apo koalicioneve të caktuara. Tash po del që ka qenë vetëm retorikë. Për ne ka qenë jashtëzakonisht befasues informacioni i mbrëmshëm që nga Vetëvendosja është kërkuar që të ndërhyjnë ndërkombëtarët apo të ketë një takim me Quintin, ku konsiderohet si një presion ndaj partnerit për themelimin e institucioneve të Kosovës", ka thënë Berisha.

Ndërsa analisti politik Faton Avdullahu ka vlerësuar se ftesa për përfaqësuesit e shteteve të Quintit dhe BE-së nga LV-ja dhe



LDK-ja krijon një dimension të ri politik. "Pavarësisht se kush i ka ftuar përfaqësuesit e shteteve të Quintit dhe BE-së, LV-ja apo LDK-ja, ato bashkë janë pajtuar se sa shumë nuk pajtohen dhe se mund të pajtohen për krijimin e qeverisë vetëm nëse mosbesimi i

tyre djallëzor zëvendësohet me garancinë ndërkombëtare. Pavarësisht se kush i ka ftuar përfaqësuesit e shteteve të Quintit dhe të BE-së, LV-ja apo LDK-ja, krijimi i mundshëm i qeverisë LV-LDK do të thotë se Kosova po hyn përsëri në një

LV - LDK



Drejtuasi i Sekretariatit për Media dhe Komunikim në Lëvizjen Vetëvendosje, Erzen Vraniqi, ka thënë se Albin Kurti dhe Isa Mustafa janë pajtuar që të ketë një takim me ambasadorët e Quintit dhe me

shefen e BE-së në Kosovë. “Si drejtues i Sekretariatit për Media dhe Komunikim dëshiroj të sqaroj për opinionin se: Në fund të takimit të mbrëmshëm ndërmjet LV-së dhe LDK-së kishte dakordim që sot ose nesër të ftohen në takim edhe ambasadorët e Quintit si dhe shefja e Misionit të BE-së në Kosovë. Kjo është konfirmuar edhe në komunikimin me tekst që ka pasur kryetari i LV-së, Kurti me kryetarin e LDK-së, Mustafa, mbrëmë në orën 19:30. Kjo është bërë me qëllim të heqjes së çfarëdo dyshimi tek ambasadorët mbi pajtimin e dy palëve për pjesëmarrjen e

ambasadorëve në takimin e sotëm. Ata nuk janë menduar asnjëherë si ndërmjetësues, por vetëm si ndihmues eventuale për çfarë vetë e kanë shprehur gatishmërinë”, ka shkruar Vraniqi në llogarinë e vet në “Facebook”.

Mirëpo LDK-ja ka mohuar një gjë të tillë. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, para fillimit të takimit ka thënë se LV-ja i ka ftuar ambasadorët në takim, duke thënë se nuk e di arsyen pse ka ndodhur një gjë të tillë. “Nuk e di, sepse ne nuk i kemi ftuar. I ka ofruar Albin Kurti. Ne do të shkojmë në takim”, ka thënë Mustafa.

Rritet për 50 për qind tentimi për thyerjen e llogarive bankare

EPOKA ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 JANAR - Siguria kibernetike vazhdon të përballet me probleme të shumta, sfida të cilat konkretisht po prekin institucionet, individët e sidomos sistemet bankare. Madje rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka theksuar se është rritur 50 për qind edhe tentimi për thyerjen e llogarive bankare, me qëllim për t'u kyçur në të dhëna.

Këtë deklaratë Hajrizi e tha në Ditën Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në punëtorinë e mbajtur me temë “Privacy in Digital Age II”, organizuar nga komuniteti CSP, në bashkëpunim me UBT-në. “Ka aspekte që e cenojnë sigurinë dhe privatësinë. Çdo ditë e më shumë po qëndron, kompleksiteti po rritet si dhe ka interesime të ndryshme për ta marrë parasysh çështjen e të dhënave. Pra, 50 për qind është rritur tentimi për thyerje të llogarive bankare. Kjo tregon

një interesim të theksuar për t'u qasur në të dhëna bankare. Në vitin 2020 do të implementohet inteligjenca artificiale, do të kalojmë në një pjesë tjetër kibernetike. Ne kemi mungesë të kadrove të sigurisë kibernetike. Por, çdo objekt do të jetë i lidhur me internetin”, ka thënë rektori Hajrizi. Ai ka thënë se vendi po përballet me mungesë të kadrove për siguri kibernetike por, sipas tij, UBT-ja është i vetmi institucion i arsimit të lartë që po punon në këtë drejtim. Sipas tij, UBT-ja po punon për akreditimin e programeve të reja dhe diplomimin e gjeneratave profesionale në këto fusha. Mentor Hoxhaj nga CSP ka prezantuar rezultatet e nxjerra nga hulumtimet për institucionet dhe organet publike dhe njohuritë për GDPR dhe ligjin e ri për mbrojtjen e të dhënave, si dhe shqetësimet e qytetarëve lidhur me privatësinë, ku ka treguar se mbi 84 për qind e anketuesve janë të shqetësuar për sigurinë dhe privatësinë në internet.

“Hulumtimi i parë ka të bëjë me ligjin për mbrojtjen dhe i dyti me perspektivën e qytetarëve në siguri. 62.5 për qind e institucioneve nuk kanë njohuri, 63 për qind nuk janë të përgatitur, 62.3 për qind nuk janë të njoftuar mbi të dhënën e të drejtat e tyre. Impakti i privatësisë 47 për qind nuk e bëjnë vlerësimin. 15.3 për qind nuk janë të shqetësuar, derisa pjesë e madhe janë të shqetësuar me privatësinë. Privatësia online është më e rëndësishme për 66.9 për qind, derisa në dokumente të shkruara është vetëm 34.6 për qind. 58 për qind nuk janë të njoftuar me të drejtat e tyre të cilat i kanë në këtë drejtim, 81 për qind pranojnë mesazhe apo qoftë marketing të drejtpërdrejtë”, ka thënë Hoxhaj. Punëtorja mbledhi përfaqësues të institucioneve shtetërore, përfaqësues të kompanive teknologjike, njëherësh edhe studentë të këtyre fushave që diskutuan gjerësisht për sfidat e sigurisë kibernetike.



epokë të re në të cilën ndikimi i ndërkombëtarëve po rikthehet fuqishëm si dikur, por tani me kërkesën e palegjitimuar të qeveritarëve në ardhje të cilët duan ta legjitimojnë grykësinë e tyre të papërmbytur”, ka shkruar ai në profilin e vet në “Facebook”.

Ambasadorët i ftoi LV-ja

Gjatë ditës zyrtarët e LV-së dhe të LDK-së kanë polemizuar në distancë rreth çështje së ftesës për ambasadorët e vendeve të Quintit në takimin e së martës.

Arrestohet një person për vrasje të pasluftës

PEJË, 28 JANAR (ER) - Prokuroria Themelore e Pejës dhe Drejtoria Rajonale e Policisë në Pejë kanë njoftuar se më datën 28 janar, rreth orës 10:00, në Komunën e Klinës, me autorizim të prokurorit të shtetit, është arrestuar nga hetuesit rajonalë, në

mbështetje të Njësitit për Reagim të Shpejtë, një person i dyshuar për një rast të vrasjes në vitin 1999 (pas luftës), nga Neni 30, al.1, të ish-Ligjit Penal të Kosovës.

"I dyshuari, pas arrestimit, është intervistuar nga hetuesit rajonalë dhe me aktvendim të

prokurorit të shtetit është ndaluar për 48 orë. Sektori Rajonal i Hetimeve i Policisë së Kosovës në Pejë për të dyshuarin ka parashtruar kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Pejë, kurse prokurori i shtetit për të dyshuarin ka bërë kërkesë për

caktimin e masës së paraburgimit në Gjykatën Themelore të Pejës, Departamenti për Krime të Rënda. Ky rast në Prokurorinë Themelore të Pejës ka qenë në rastet e shenjësuar të vrasjeve të pasluftës të ndodhura në kompetencën



territoriale të këtij institucioni", është bërë me dije në komunikatën e Prokurorisë Themelore të Pejës.

Tërnavë në Kajro, pjesë e konferencës ndërkombëtare 'Përtëritja e mendimit islam'



PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Me ftesë të Shejh el Ezherit, Imamit të Madh, prof. dr. Ahmed Tajjib, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnavë, po

merr pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë mbi 'Përtëritjen e mendimit islam', ku po marrin pjesë dijetarë, intelektualë, myftinj e ministra të çështjeve fetare nga më

shumë se 41 shtete të ndryshme nga mbarë bota islame. Konferenca do të zgjasë dy ditë dhe do të jetë e ndarë në shtatë seanca.

Temat kryesore të seancave janë këto: kornizat e përtëritjes, mekanizmat e përtëritjes, përmirësimi i koncepteve të gabuara, përtëritja në fushën e çështjeve

familjare dhe femrës, roli i institucioneve fetare dhe akademike në përtëritjen e mendimit islam, përtëritja dhe siguria shoqërore dhe sfidat e përtëritjes.

Në Urologji kryhet një operacion i komplikuar

PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Në Klinikën e Urologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës mjekët kanë kryer një operacion të rrallë, duke ndërhyrë në veshkën e majtë te një pacient, e cila ishte përfshirë nga një masë tumorale.

Pas përgatitjes preoperatorë, ekzaminimeve të nevojshme diagnostike, ekipi mjekësor i ka larguar pacientit veshkën ektopike (veshkë jashtë pozitës normale), së bashku me masën tumorale dhe ureterin e majtë (kanali që lidh veshkën me fshikën

urinare). Sëmundjet e tilla janë shumë të rralla. Deri më tani, rreth 13 raste janë të evidentuara në literaturën botërore. Pacienti i moshës 78-vjeçare, me inicialet H. T., është liruar në shtëpi me gjendje të mirë shëndetësore.



Ministrja Hoxhiq takon shefin e Zyrës Ndërlidhëse të Sllovakisë

PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Ministrja e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Adrijana Hoxhiq, është takuar të martën me shefin e

Zyrës Ndërlidhëse të Republikës së Sllovakisë, Rastislav Kosltilnik. Në takim u diskutuan për aktivitetet e ministrisë si dhe planin për

periudhën e ardhshme, bashkëpunimin dhe situatën aktuale në Kosovë. Bashkëbiseduesit kanë shprehur gatishmërinë e tyre

për bashkëpunim të ngushtë në të mirën e qytetarëve, duke krijuar kushte më të mira dhe kualitative për jetesë.



Rasti 'veteranët', mbetet i paqartë numri i përfituesve të pensionit

PRISHTINË, 28 JANAR - Përfaqësuesit e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës thonë se rreth dy mijë persona, kryesisht ata që kanë falsifikuar dokumentet për ta fituar statusin e veteranit të luftës, janë larguar nga lista e përfituesve të pensionit. Por, këto të dhëna nuk janë konfirmuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila nuk ka informacione se dikush është larguar nga lista e pensionit të veteranit të luftës.

Hysni Gucati, kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se ka rënë dukshëm numri i personave që tash nuk marrin pensione. Nga shifra prej rreth dy mijë vetave, sa ai mendon se janë larguar nga lista, Gucati thotë se 400 prej tyre ishin nga Shqipëria. "Rreth dy mijë (2 000) veta janë larguar nga pagat. Njëzet (20) veta janë persona që janë zënë me certifikata dhe vendime false (të rreme), ata veç janë duke e vuajtur dënimin dhe janë të regjioneve të ndryshme, të komunave të ndryshme. Kështu që kjo është reale. Muajin e kaluar 2 000 veta nuk kanë marrë paga fare se janë të larguar nga listat", ka thënë Gucati. Gucati ka theksuar se në muajin dhjetor 2019 pensione kanë marrë më shumë se 37 mijë veteranë. "Deri vonë pensione kanë marrë mbi 39 mijë, tash ka rënë numri në mbi 37 mijë. Do të thotë, prokuroria është duke punuar. Ne e kemi përkrahur prokurorinë edhe më herët. Do ta përkrahim edhe tash, se për ne është mënyra më e mirë që ka filluar puna gradualisht, pa zhurmë, që po largohen nga listat e pensioneve ata që s'e meritojnë", ka thënë Gucati.

Në anën tjetër, në Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale thonë se, pavarësisht prej hetimeve, ministria nuk është e informuar zyrtarisht nga askush lidhur me largimin nga lista të asnjë personi që ka marrë më herët pension.

Në këtë ministri thonë se shifrat bazohen në Draftin e Listës së Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës. "Nga lista e



përfituesve të pensionit të veteranit të luftës nuk është larguar asnjë shfrytëzues si mashtrues, apo siç po quhen 'veteranët të rrejshëm', pasi që në këtë departament nuk ka ardhur asnjë kërkesë zyrtare nga organet kompetente për ndërprerje të pensionit. Ligjërisht derisa ne nuk kemi asnjë shkrues të tillë zyrtarë nuk mund të largohet askush nga lista", është thënë në përgjigjen me shkrim nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Sipas të dhënave nga kjo ministri, në muajin dhjetor të vitit 2019 në skemën e përfituesve të veteranëve të luftës kanë qenë 38 101 veteranë, kurse në janar të këtij viti në listën e pagesës janë 38 156 përfitues të kësaj skeme, që nënkupton shtimin e numrit të përfituesve dhe jo pakësimin e tyre.

Ndërkohë, Hysni Gucati thotë për "Radion Evropa e Lirë" se nuk e di se si janë raportet e bashkëpunimi

mes ministrisë apo qeverisë dhe mekanizmave të tjerë për këtë çështje, por ai shprehet i bindur që më shumë se dy mijë persona janë larguar nga lista.

Gucati ka pohuar se as shoqata që ai përfaqëson nuk ka arritur të sigurojë një listë finale të personave që marrin pension si veteran. "Listat nuk na i kanë dhënë, i kam kërkuar disa herë. Kam kërkuar të di sa marrin paga dhe sa kanë hyrë gjatë këtij viti. Kështu që mua, zyra për këtë çështje, që është pranë kryeministrisë, nuk më ka dhënë asnjëherë përgjigje", ka deklaruar Gucati.

Prokuroria Speciale e Kosovës, nga provat e siguruar, ka vërtetuar se nga pagesat e kundërligjshme për veteranët luftëtarë të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, buxheti i Republikës së Kosovës është dëmtuar në shumën mbi 68 milionë euro.

Kjo Prokurori ka njoftuar kohë më parë se "ka ngritur aktakuzë, të cilën e ka dërguar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër 12 të pandehurve, për lëndën e njohur në opinion si 'veteranët', në drejtim të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar".

Prokuroria e Shtetit ka thënë se numri i përfituesve të jashtëligjshëm nga kjo kategori mund të jetë deri në 19 mijë veta. Një numër kaq i madh i përmendur nga Prokuroria kishte nxitur reagimin e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, duke thënë se në këtë listë me numër kaq të madh të personave kishte edhe emra të shumë ish-luftëtarëve që kanë luftuar nën emblemën e UÇK-së. Kjo organizatë ka shprehur zhgënjimin lidhur me atë se si prokuroria ka bërë gabime të tilla, duke kërkuar

përmirësim të menjëhershëm të listave.

Hetimet po zhvillohen në rajone të ndryshme të Kosovës. Kështu vetëm në Prokurorinë Themelore në Prizren kanë thënë për "Radion Evropa e Lirë" se janë duke u hetuar rreth 150 persona. "Prokuroria Themelore në Prizren ju njofton se sa iu përket rasteve të manipulimeve me listat e veteranëve, në Prokurorinë Themelore në Prizren janë duke u hetuar rreth 150 persona. Prokuroria është akoma në fazën fillestare të grumbullimit të informacioneve dhe provave të nevojshme dhe se për rastet në fjalë do të vepohet konform dispozitave ligjore", thuhet në përgjigjen e prokurorisë. Po në Prizren, Gjykata Themelore tha për "Radion Evropa e Lirë" se janë të informuar për 32 raste, por që ende nuk ka një vendim gjyqimi.

Ambasadori Abbott informohet për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur



PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Ambasadori britanik në Kosovë, Nicholas Abbott, ka vizituar të martën Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur, me ç'rast ka takuar bartësit e institucioneve qeveritare, të angazhuar në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur.

Gjatë takimit ambasadori Abbott u informua me infrastrukturën ligjore dhe institucionale, si dhe me angazhimet e Qeverisë së

Republikës së Kosovës për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur dhe sfidat me të cilat përballet ky proces, duke theksuar në veçanti mungesën e ofrimit të informatave nga autoritetet e Beogradit.

Përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës, të angazhuar në këtë proces, vlerësuan lart përkrahjen e Ambasadës Britanike, gjegjësisht Mbretërisë së Bashkuar në vazhdimësi, në veçanti pas vizitës

së Princit Charles në Republikën e Kosovës gjatë vitit 2016.

Ambasadori Nicholas Abbott ka shprehur përkushtimin e Ambasadës dhe angazhimin e tij personal në përkrahjen e mëtejshme të këtij procesi, me theks të veçantë në adresimin e obligimeve që dalin nga "Deklarata e Përbashkët e Kryeministrave për Çështjen e Personave të Zhdukur" të nënshkruar në Samitin e Londrës.

Miratohet plani i komitetit për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së

MALISHEVË, 28 JANAR (ER) - Komiteti për familje të dëshmorëve, invalidë, veteranë të luftës së UÇK-së dhe martirë të luftës së fundit ka mbajtur mbledhjen e rregullt, të cilën e ka drejtuar kryesuesja Vlora Krasniqi-Manaj.

Në këtë mbledhje është miratuar plani i punës së këtij komiteti për vitin 2020. Sipas këtij plani, objektivat kryesore që presin të realizohen gjatë këtij viti janë: shqyrtimi i rregullt i punës dhe veprimeve të organeve komunale me fushë-

veprimtarinë e komitetit, adresimi i kërkesave dhe rekomandimeve, komiteti duhet të jetë pjesë e akademive përkujtimore dhe organizimeve të festave kombëtare, krijimi i data-bazës me të gjitha data historike të Komunës së

Malishevës.

Komiteti për familje të dëshmorëve, invalidë, veteranë të luftës së UÇK-së dhe martirë të luftës, ka paraparë edhe disa vizita nëpër institucionet lokale e qendrore që lidhen me punën dhe veprimtarinë e këtij komiteti.



LDK-ja dhe LV-ja kërkojnë dorëheqjen e Shpend Ahmetit

PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Grupi i Asamblistëve Komunalë të LDK-së në Prishtinë ka mbajtur konferencë për medie, në të cilën ka akuzuar kryetarin Shpend Ahmeti për keqqeverisje dhe keqmenaxhim.

Asamblisti i LDK-së në Komunën e Prishtinës, Shefqet Osmani, ka theksuar se performanca menaxhuese e Shpend Ahmetit po del të jetë ashtu siç e kanë analizuar. "Ne nga viti i kaluar kemi ngritur shqetësimin rreth performancës

menaxhuese të kryetarit Shpend Ahmeti dhe paaftësisë së tij në drejtimin e Komunës së Prishtinës. Në bazë të parashikimeve dhe analizave del të jetë se parashikimi i shpenzimeve në parametrat e projektuar po del të jetë i saktë. Në periudhën janar-dhjetor 2019 janë paraqitur të dhëna skandalozë e që më i theksuar është mosshpenzimi i buxhetit. 28 milionë euro nuk është përfundimtare për vitin 2020", ka thënë Osmani.

Më tutje, ai ka thënë se Ahmeti ka dështuar edhe në planifikimin strategjik dhe në urbanizëm. Pas gjithë këtyre dështimeve, ai ka thënë se Shpend Ahmeti do të duhej të jepte dorëheqje dhe të kërkonte falje publike. "Shpend Ahmeti i ka humbur rrugën në oborr. Nëse i ka mbetur veç pak moral dhe ndërgjegje, Shpend Ahmeti do duhet së paku të dorëhiqet nga pozita e kryetarit dhe të kërkojë falje publike", është shprehur ai.

Dorëheqjen e Shpend Ahmetit e ka kërkuar edhe deputetja e Vetëvendosjes, Fitore Pacolli. Ajo ka thënë se edhe 30 mijë qytetarë janë duke e kërkuar dorëheqjen e Ahmetit.



Deputetet nga rajoni i Anamoravës flasin për transparencë

KAMENICË, 28 JANAR (ER) - Deputetet e Kuvendit të Kosovës në bashkëpunim me KDI-në dhe OJQ-në "Fortesa" kanë mbajtur raundin e dytë të debatit në Komunën e Kamenicës, me temë "Tarrisim transparencën dhe llogaridhënien ndaj zgjedhësve". Në këtë takim të pranishëm ishin deputetet: Lirije Kajtazi, Labinotë Demi, Arbëreshë Kryeziu, ndërsa nga KDI-ja Agnesa Haxhiu si dhe drejtoresha ekzekutive e OJQ-së "Fortesa", Sanije Jahiri. Po në debat kanë marrë pjesë edhe qytetarë si dhe përfaqësues të Komunës së Kamenicës. Gjatë debatit është diskutuar çështja e përfaqësimit të kësaj komune nga deputetet në Kuvendin e Kosovës, se si do t'i adresojnë kërkesat e qytetarëve të Kamenicës.

Deputetet kanë kërkuar nga të



pranishmit t'i paraqesin shqetësimet e tyre, duke u thënë që transparenca me bashkëpunim është ajo që duhet t'i karakterizojë të zgjedhurit e qytetarëve. Ndër të tjera, edhe të pranishmit në këtë takim paraqiten disa rekomandime duke iu kërkuar deputeteve që të punojnë më shumë për përfaqësimin e qytetarëve.

Korrupsioni dhe krimi i organizuar, fajtorët kryesorë të ngecjes së Kosovës në integrimin në BE



PRISHTINË, 28 JANAR - Politizimi i administratës publike, korrupsioni, krimi i organizuar, si dhe sistemi gjyqësor joefikas mbeten fajtorët kryesorë të ngecjes së Kosovës në integrimin në BE. Kështu u tha në publikimin e hulumtimit rajonal të D4D të quajtur "Reformat institucionale dhe legjitimiteti demokratik në Kosovë, Shqipëri dhe Mal të Zi".

Prezantimi i këtij hulumtimi për Kosovën është bërë nga Valëza Zogjani, hulumtuese e politikave në D4D. Ajo ka thënë se Kosova konsiderohet vend kandidat potencial për t'u anëtarësuar në BE dhe se nga pavarësia rruga e integritimit në BE ka qenë një prioritet i pavarur dhe i ndërlidhur i politikës së jashtme për Kosovën. Mirëpo, ajo ka pohuar se edhe pas 12 vjetëve pas pavarësisë synimet e Kosovës për integritime evropiane nuk janë shumë të prekshme. "Muajin tjetër bëhen 12 vjet që Kosova ka shpallur pavarësinë dhe, fatkeqësisht, rezultatet e integritimeve, synimeve tona për integritime evropiane, nuk janë shumë të prekshme. Fatkeqësisht, administrata e politizuar, korrupsioni, krimi i organizuar, si dhe sistemi gjyqësor jofunksional mbeten ndër arsyt ose faktorët kryesorë që po e pengojnë Kosovën drejt avancimit të përpjekjeve të saj për në Bashkimin Evropian", ka thënë ajo.

Të dhënat për Malin e Zi i ka prezantuar Nina Kecojeviq, hulumtuese e politikave publike në CEMI, e cila ka thënë se elitat politike në këtë vend sërish kanë vendosur interesin privat dhe partiak para atij publik. Ndërkaq drejtori i Departamentit të Koordinimit të Politikave të MSA-së në Ministrinë e Integritimeve Evropiane, Artan Çollaku, ka theksuar se si administratë

kanë arritur t'i plotësojnë kushtet e MSA-së brenda disa muajve por që, sipas tij, reformat e ndërmarra nuk janë të qëndrueshme. "Krahasuar me vendet e tjera, Kosova si shtet i ri e ka një administratë, ndonëse me probleme e cila konkretisht në lidhje me MSA-në ka arritur për një kohë relativisht të kënaqshme për t'i kryer ato detyra teknike duke filluar prej liberalizimit të vizave, plotësimit të kriterëve, negociimit të MSA-së, për shembull për kriteret formale si parakusht për negociimin e MSA-së i ka plotësuar shumë shpejt, brenda disa muajve. Por, nuk mjafton ajo, ato janë veç kriteret formale të cilat pastaj përballen me dy probleme kryesore që e bëjnë këtë ndikimin ndërkombëtar të domosdoshëm dhe na lënë neve si të paaftë, jo shumë të gatshëm për t'u marrë me problemet tona", ka deklaruar ai.

Ndërsa drejtori ekzekutiv i Institutit Epik, Demush Shasha, ka thënë se Kosova ka bërë përparim në rrugën e saj integruese në dhjetë vjetet e fundit. "Kosova ka bërë përparim në rrugën integruese në dhjetë vjetet e fundit. Ka bërë përparim sepse pas shpalljes së pavarësisë arritëm për të negociuar MSA-në, e cila ka themeluar marrëdhënie kontraktuale mes nesh dhe BE-së. Pra, le të themi ka vulosur të ardhmen tonë për anëtarësim në BE. Vini re, prej cilitdo vend, prej filleve të procesit integruese deri në anëtarësimin në BE nënshkruhen vetëm dy dokumente, MSA dhe në fund procesi i traktatit i anëtarësimit", ka thënë Shasha.

Hulumtimi "Reformat institucionale dhe legjitimiteti demokratik në Kosovë, Shqipëri dhe Mal të Zi" mbështetet nga Fondi Evropian për Ballkanin.

Kuvendi Komunal i Prishtinës rekomandon anulimin e kushteve ndërtimore në Badoc

PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Kuvendi Komunal i Prishtinës në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur të martën ka miratuar dy rekomandime dhe ka marrë një vendim lidhur me ndërtimet në afërsi të liqenit të Badocit në kryeqytet. Kuvendi ka rekomanduar që liqeni i Badocit të hyjë te Zona e Peizazhit të Mbrojtur dhe të anulohen kushtet ndërtimore për palën e përfshirë në këtë proces.

Gjithashtu, është marrë vendim që të anulohet Plani Zhvillimor Komunal për Zonën I, II dhe III. Rekomandimet dhe vendimi kanë dalë nga kërkesa e grupit të qytetarëve për mbrojtjen e liqenit të Badocit.

Gjatë kësaj seance është zhvilluar një debat i ashpër sidomos në mes të asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje dhe atyre të PSD-së. Kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka

thënë se ka pasur presion nga Vetëvendosja për lejimin e ndërtimeve në liqenin e Badocit. Ai ka theksuar se është pro anulimit të kushteve të ndërtimit por, sipas tij, një gjë të tillë duhet ta bëjë fillimisht Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). "Mos më shtini me fol, se presionin më të madh për këtë lagje e kam pasur nga Vetëvendosja", u ka thënë Ahmeti asamblistëve të LV-së.



Bizneset me shumë probleme për zhvillimin e tyre

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 28 JANAR - Bizneset kanë shpalosur problemet dhe kërkesat e tyre përballë drejtorit të përgjithshëm të Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, në një takim të përbashkët të organizuar të martën nga Oda e Afarizmit të Kosovës.

Takimin e hapi kryetari i OAK-së, Skënder Krasniqi, me një fjalë rasti duke e falënderuar drejtorin e përgjithshëm të Doganës për bashkëpunimin e deritanishëm dhe përgjigjen pozitive ndaj kërkesave të OAK-së sa herë që bizneset kanë kërkesa për takim apo trajtim të çështjeve që i shqetësojnë ata.

Drejtori i Doganës, Bahri Berisha, ka shpalosur punën dhe të arriturat e institucionet që drejton gjatë viteve të fundit. Ai ka thënë se është duke punuar për lehtësim të procedurave doganore dhe për krijimin e lehtësirave tregtare për bizneset, duke marrë parasysh dy faktorë kryesorë që kanë rëndësi shumë të madhe: koston operative dhe kohëzgjatjen.

Pronari i "Eco House", Dardan Zogiani, kompani kjo që merret me qeramikë, ka theksuar disa nga barrierat me të cilat po përballlet si

biznes e që kanë të bëjnë kryesisht me rivlerësimin e mallit, si një dukuri që po i ndodh tash e disa herë, duke thënë se mallrat që po hyjnë brenda Kosovës po mbivlerësohen.

Ndërkaq Shaban Muja nga "Art Aluminium", fabrikë për prodhimin e aluminit, ka thënë se Kosova importon një sasi të madhe të aluminit nga Turqia gjë e cila, sipas tij, po i dëmton prodhuesit e aluminit në Kosovë. Ai ka theksuar se duhet të vendoset një tarifë më e lartë ndaj prodhuesve të huaj të cilët sjellin mallra në Kosovë në mënyrë që të mbrohet prodhuesi vendor.

Më tutje, Xhevat Muqa nga "Muqa Solar" u shpreh i indinjuar me sjelljen që, sipas tij, po e bëjnë në disa raste doganierët kundrejt bizneseve. Ai ka propozuar që doganierët duhet të ndjekin sa më shumë trajnime, në mënyrë që puna e tyre të jetë sa më profesionale.

E Fazli Fetahaj nga "KLI" u shpreh i pakënaqur me procedurat brenda Doganës dhe ka përmendur gjërat që janë aplikuar nga Dogana kundrejt biznesit të tij.

Kurse Jakup Berisha nga Shoqata e Transportit Rrugor ka theksuar se autobusët që importohen në



Kosovë duhet të lirohen nga doganimi duke u trajtuar si mjet themelor për kompani e jo mjet personal.

Ramadan Onjeva nga shtypshkronja "Era" në Ferizaj që bën prodhimin e kutive dhe ambalazheve për prodhuesit ushqimorë dhe barnave u shpreh i shqetësuar me klasifikimin e llojeve të letrës në numra taritorë që, sipas tij, nuk janë bërë në mënyrë të duhur.

Ndërkaq Enver Jetullahu nga firma transportuese "E.N. Logistics" ka pohuar se ndihet i diskriminuar me mënyrën se si trajtohen transportuesit kosovarë

dhe mënyrën se si po trajtohen transportuesit fqinj doganë.

Gentiana Sahiti, përfaqësuese e "Gjirafa", tha se duhet të përshpejtohet procesi i tregtisë përmes internetit apo "E-commerce", duke i shkurtuar pritjet e gjata për shqyrtimin e mallit në doganë.

Të gjitha këtyre shqetësimeve dhe pyetjeve iu përgjigj drejtori i Doganës, duke thënë se Dogana po mundohet ta bëjë më të mirën e mundshme në punën e saj. Ai ka thënë se po mundohet të krijojë lehtësira për bizneset, mirëpo ka bërë me dije se Dogana në Kosovë vepron në bazë të ligjit dhe në

bazë të politikave fiskale në vend. Berisha ka përmendur edhe reformat e reja brenda Doganës, përfshirë këtu digjitalizimin e shërbimeve doganore, po ashtu ka përmendur vlerësimin e lartë të punës së Doganës nga Banka Botërore. Ai ka theksuar se Kodi i ri Doganor është në procedurë dhe do të hyjë në fuqi këtë vit.

Në fund të takimit ishte konkludim i përbashkët se bizneset duhet të jenë shumë më shumë aktive në përmirësimin e ligjeve dhe udhëzimeve administrative në mënyrë që të ketë më shumë rritje ekonomike dhe më pak pengesa.

Kartëmonedha prej 100 eurosh, më e falsifikuara në tregun e Kosovës

PRISHTINË, 28 JANAR - Rreth 70 mijë euro është vlera e parave të falsifikuara të cilat ishin vënë në qarkullim në tregun e Kosovës vetëm brenda pjesës së parë të vitit 2019. Kartëmonedha më e falsifikuar, sipas të dhënave të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, të cilat i janë dërguar "Radios Evropa e Lirë" nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), ka qenë ajo prej 100 eurosh, ndërkaq prej monedhave kanë qenë ato në prerje prej 2 dhe 1 euro.

Denominimet në vlerë prej 500, 200 dhe 50 euro përbëjnë përqindje më të vogël të numrit të kartëmonedhave të falsifikuara, përkatësisht rreth 17 për qind.

Zyrtarë të Bankës Qendrore të Kosovës bëjnë të ditur për "Radios Evropa e Lirë" se duke u bazuar në raportet statistikore të pranuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë për tri vjetet e fundit, shihet një rritje e



rasteve të parave të falsifikuara por, siç thonë ata, kjo rritje nuk është në nivel shqetësues.

Zëdhënësi i BQK-së, Kushtrim Ahmeti, ka thënë për "REL" se Kosova i ka kapacitetet e veta ligjore dhe institucionale për luftimin e dukurisë së falsifikimit të parave. Sipas tij,

lufta kundër kësaj dukurie është një aktivitet i përditshëm i të gjitha institucioneve përgjegjëse. "Bazuar në raportet e fundit të pranuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, në gjysmën e parë të vitit 2019 janë identifikuar një numër prej 656

kartëmonedhash dhe 2 184 monedhash të falsifikuara, të cilat janë tërhequr nga qarkullimi, kurse shumica e tyre ishte rreth 65 695.00 euro (para letre), përkatësisht 3 244.45 euro (para metali). Pjesa më e madhe e këtyre kartëmonedhave dhe monedhave janë konfiskuar nga institucionet financiare gjatë aktivitetit të tyre të rregullt", thotë Ahmeti.

Falsifikimi i parave është veprë penale dhe sanksionohet sipas nenit 302 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës dërguar "REL"-it, për veprën penale 'falsifikim i parave' janë regjistruar 619 raste, ndërsa në vitin 2019 janë të evidentuara 590 raste.

Policia e Kosovës nuk ka dhënë edhe vlerën e parave të falsifikuara të cilat janë konfiskuar gjatë këtyre operacioneve të organeve të rendit. Të dhëna të vlerës së

parave të falsifikuara polica ka paraqitur në dy rastet e fundit të operacioneve të ndara që kanë të bëjnë me veprën penale falsifikim i parave.

Vetëm në një rast, gjatë këtij muaji, Policia e Kosovës ka thënë se ka parandaluar prodhimin e mbi 4 milionë dollarëve të falsifikuar, ndërsa në një rast tjetër ka kapur rreth 4 mijë euro para të falsifikuara. Në të dy rastet, Policia e Kosovës ka arrestuar disa persona të dyshuar. Në janar të vitit 2012 Kosova kishte konvertuar valutën, duke kaluar nga valuta marka gjermane (DEM) në valutën euro.

Në atë kohë Banka Qendrore e Kosovës në bashkëpunim me Policinë e Kosovës bënë angazhime të veçanta në fushën e edukimit dhe luftimit të parave të falsifikuara, si dhe themeluan Komitetin Kombëtar për Luftimin e Parave të Falsifikuara.

Reçica në Sarajevë, pjesë e konferencës 'Punësimi, hijet gri në Ballkanin Perëndimor'

Prishtinë, 28 janar (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, me ftesë nga Këshilli Rajonal i Bashkëpunimit, është duke marrë pjesë në konferencën me temë "Punësimi, hijet gri në

Ballkanin Perëndimor", mbajtur në Sarajevë, konferencë që po bën bashkë ministra dhe zyrtarë nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. "Gjatë konferencës paraqita gjendjen aktuale me të cilën po bal-

lafaqohet Kosova, me papunësi të madhe, informalitetin në punë, si dhe masat të cilat janë ndërmarrë për t'i adresuar këto çështje. Theksova se Kosova ka nevojë për hapjen e më shumë vendeve të reja të punës me qël-

lim të stabilitetit të tregut të punës dhe, gjithashtu, ta mbikëqyrë mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe sigurisë dhe shëndetit në punë", ka shkruar Reçica në llogarinë e vet në "Facebook".



Pikëpamjet e profesor Rexhep Qosjes për Albanologjinë (3)

VI. Kontributet në fushë të historisë

Prof. asoc. dr. Myrvete
Dreshaj-Baliu
Prof. dr. Begzad Baliu

Le të thuhet këtu, se gjykimet e tij për qasjen ndaj trashëgimisë materiale e shpirtërore shqiptare, më parë se sa me kërkimet dhe studimet në Kosovë kishin të bënin me kërkimet dhe sidomos me studimet në fushë të folklorit dhe etnografisë në Shqipëri, të cilat vazhdonin t'iu nënshtroheshin qasjeve dogmatike të metodave të realizmit socialist. Në këtë rrjedhë ai orientonte kërkimet shkencore edhe në kontekst të afirmimit të tyre shkencor, duke theksuar se: "afirmimi i gjykimet objektiv, kritik, si gjykim i vetëm, vërtet, shkencor. Dhe, afirmimi i gjykimet objektiv kritik, si gjykim i vetëm, vërtet, shkencor mund të arrihet nën kushtin e evitimit të superlativizmit të shprehjes, të patetikës së ndjenjës, të vrojtimeve folklorizante të ornamentalizmit të traditës kulturore dhe historike, me një fjalë nën kushtin e evitimit të mendimit diletant, që karakterizon subjektivizmin, që cenon etikën e shkencës, dhe, ashtu, ulë dinjitetin e mendimit shkencor përgjithësisht".

Kjo natyrisht nën një mënyrë nuke nënkupton ndonjë qëndrim të veçantë kundër trashëgimisë sonë. Përkundrazi. Studiuesi që ishte lindur dhe formuar në rininë e tij në një krahinë tipike etnografike epike, studiuesi që në fillimet e tij shkencore kishte paraqitur për tezë doktorate krijimtarinë letrare të shkrimtarit më të madh të epikës shqiptare Gjergj Fishta, nuk mund të pritej që të kishte qëndrim indiferent, e aq më pak mohues ndaj folklorit. Qëndrimet e tij të ashpra ndaj folklorit dhe trashëgimisë shpirtërore si përbërës i letërsisë artistike, para se gjithash kishin të bënin me qasjen ndaj saj. Duke bërë vlerësimin e veprës së Kadarese Autobiografia e popullit në vargje, ai veç tjerash theksonte: "të ngrihesh, më në fund, kundër provincializmit, etnografizmit dhe folklorizmit në letërsinë kombëtare doemos duhet të zotohesh sa për frymën kombëtare aq edhe për frymën universale të saj. Përse? Për arsyen e thjeshtë se një letërsi e vërtetë është, vërtet, nacionale, shpreh tamam shpirtin kombëtar, në qoftë se është, vërtet, universale. Vlerat artistike janë kuptimisht universale ose s'janë as nacionale". Pamja përkatësisht qasja komplementare e këtyre dy përbërësve, atij kombëtar dhe atij evropian, në të vërtetë atij kombëtar dhe atij universal edhe në fushë të studimit, për profesor Qosjen është një prej kushteve themelore për të arritur rezultatet e dëshiruara shkencore në fushë të studimit të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të popullit shqiptar. "Studimi krahasimtar i këtyre vlerave, -

shkruante profesor Qosja, - por studimi i tyre i çliruar prej egoizmit dhe prej paragjykimëve kombëtarë, në të vërtetë pseudokombëtarë, doemos realizon një prej qëllimeve të rëndësishme të shkencës: zgjeron horizontet e dijes në përgjithësi dhe, sidomos, afirmon besimin e arsyes së kulturës jonë kombëtare ishte dhe është shumëfish e lidhur me kulturën evropiane, se i takon bashkësisë shpirtërore evropiane".

Prej studiuesit, i cili që në fillimet e tij shkencore merrej me kritikën letrare dhe me studimet historiko-letrare njëkohësisht, ishte e kuptueshme që një ditë të pritej përkushtimi ndaj studimeve krejtësisht historiko-letrare, por prej studiuesve të tillë jo gjithmonë është pritur të bëhen edhe studiues të historisë, pjesë e saj dhe njëkohësisht bartës të kalimit të popullit të tij në kthesat e mëdha jetësore. Mbase për shkak se, që në fillimet e tij ka treguar shprehje kritike ndaj vlerave kulturore bashkëkohore dhe letrare e historike, ai njëkohësisht ka dëshmuar edhe vetëdije të lartë historike, prandaj edhe me kohë është bërë bardi i kalimit të popullit shqiptar në shtigjet më të vështira të historisë së tij në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe në gjysmën e parë të shekullit XXI. Dhe, do të bëhet kështu, me jetën dhe veprën, jo vetëm studiues po edhe dëshmitar, e pjesëmarrës i saj.

"Në fushën e historisë, - shkruante Profesor Qosja në sprovën e tij Mbledhja e lëndës dhe sintezat shkencore, - shfaqet e nevojshme që përqendrimin e deritanishëm në historinë e Rilindjes Kombëtare ta shoqërojmë me studimin po aq të përqendruar të historisë së vjetër - të rezultateve të gjurmimeve arkeologjike, të historisë mesjetare, sidomos të periudhës iliro-bizantine dhe të periudhës shqiptaro-sllave. Historia e banorëve të Kosovës gjatë këtyre periudhave është mjaft e panjohur apo, sikundër sinjalizojnë rezultatet e para të disa studiuesve mbas Luftës së Dytë Botërore, është njëanshëm e njohur. Sa i përket historisë së kohës së re, e cila është mbuluar me një numër më të konsideruar kuadrosh qoftë në Universitet, qoftë edhe në vetë Institutin, kujdes i veçantë do të duhej t'i kushtohet hetimit të arkivave të proveniencës jugosllave, të shtypit, të periodikut dhe të literaturës përkatëse të shekullit të shkuar dhe të shekullit tonë. Po kjo mund të thuhet edhe për kohën ndërmjet dy luftërash botërore. Në të gjitha këto periudha do të duhej të bëhen hetime të problemeve të veçanta me synimin që të përgatiten studime komplete monografike të periudhave të tëra, që proceset historike do t'i ndriçonin, ashtu, në rrjedhat më të gjata kohore. Në këtë mënyrë i hapet rruga ndriçimit të plotë, shkencërisht të qëndruar, të historisë së këtyre trojeve".



Po t'i bëhet një sinopsis programit të tij mbi orientimet shkencore në fushë të kërkimeve dhe studimeve historike nuk është vështirë të përcaktohen disa nga çështjet thelbësore që i ka përcaktuar dhe disa nga rrafshet kohore në të cilat është orientuar: 'rilindja kombëtare', 'historia e vjetër', 'gjurmimet arkeologjike', 'historia mesjetare', 'periudha iliro-bizantine' 'periudha shqiptaro-sllave', "historia e banorëve të Kosovës" etj. Për shkak se sikur konstatonte profesor Qosja, në periudhën e Rilindjes Kombëtare viteve të fundit ishin bërë kërkime të gjera dhe të thelluara, tani kishte ardhur koha të bëheshin hetime në rrafshin kohor dhe hapësinor. Ajo që të bënte përshtypje me këtë kontekst ishte kërkesa për të bërë gjurmime arkeologjike dhe për t'u përqendruar në historinë mesjetare e atë iliro-bizantine. Arsyet do t'i thoshte vetëm pjesërisht më vonë dhe ato kishin të bënin me mohimin e studiuesve sllavë të prejardhjes ilire të popullit shqiptar e të gjuhës shqipe, si dhe njëanshmërinë e paraqitjes së pasqyrës etnike mesjetare në hapësirën e Kosovës. Ato kishin të bënin me njëanshmërinë e kërkimeve arkeologjike në Kosovë gjatë pothuajse gjithë shekullit XX nga shkencëtarët serbë, duke u përqendruar vetëm në trashëgiminë ortodokse e bizantine dhe kryesisht në periudhën mesjetare; ato kishin të bënin më në fund, me prirjen e shkencës serbe që historinë e banorëve të Kosovës mesjetare ta shoh vetëm në traditën kishtarë ortodokse të emrave dhe të miteve të rekonstruara kryesisht në shekullin XIX.

Megjithëse me fjalët, sprovat dhe programet e shkruara gjatë viteve

'60 -'70 Profesor Qosja kishte bërë sinopsiset e orientimit dhe organizimit të shkencës së albanologjisë, duke i parë fushat e saj veç e veç në gjendjen dhe perspektivën e tyre, në gjendjen institucionale në Kosovë dhe në perspektivën evropiane të kësaj dijeje, askush nuk ka pritur që shumë prej këtyre fushave të bëheshin objekt kërkimi e studimi edhe nga vetë ai.

Prej kërkimeve shkencore të tij në fushë të historisë së albanologjisë, pritej që historia, kultura dhe sidomos letërsia shqipe të shiheshin edhe në prizmin e studimeve ballkanike, evropiane e botërore në njërin anë dhe në prizmin e kulturave fqinje e evropiane në anën tjetër. Në të vërtetë, prej orientimeve të tij shkencore pritej që Profesor Qosja të merrej me historinë dhe përgjithësisht qytetërimin a kulturat letrare: latine, helene, perse, gjermane, franceze, italiane, sllave, greke, rumune etj., prej të cilëve janë ndikuar apo janë frymëzuar shkrimtarët shqiptarë apo veprat e tyre përkohërisht me vlerat e tyre gjuhësore dhe letrare. Pas veprave të tij të periudhës së parë, të botuara kryesisht deri në fillim të viteve '80, vështirë të besohej se Profesor Qosja, do të merret aq përkushtueshëm me fatet historike të popullit shqiptar, sa të shkruajë edhe një nga veprat më të mira për çështjen shqiptare të epokës së re. Për më tej, pas botimit të tri vëllimeve të para për Romantizmin, vështirë të besohej se do ta ndalonte përkohësisht punën në projektin e madh të Historisë së letërsisë shqipe. Ky ndalim i përkohshëm edhe më shumë se tri dekada më pas është bërë ndalesë që vazhdon. Gjatë këtyre më shumë se tri dekadave në

vazhdim Profesor Qosja ka botuar vepra për historinë e letërsisë, vëllime me ese, vëllime me intervista, sprovat teorike, historike, sociale, antropologjike e polemizuese, ditarë në shtatë vëllime, si dhe disa vepra shumë të rëndësishme në fushë të historisë së çështjes kombëtare: Nezašticasudbina: O Albancima u Jugoslavijanas (1990), Populli i ndaluar (1990), Strategjia e bashkimit shqiptar (1992), Çështja shqiptare - historia dhe politika (1994), Ligjërime paravajtëse (1996), Fjalor demokratik (1997), Paqja e përgjakshme (1999), Tronditja e shekullit I, II (2001), Shpërngulja e shqiptarëve sipas programeve kombëtare serbe (2005) etj., por nuk e ka botuar asnjë nga vëllimet e projektuara dhe të paraqitura në fund të parathënies së vëllimit të parë të Historisë së letërsisë shqipe! Prej vëllimeve të botuara në fushë të publicistikës, të politikës a të antropologjisë, nuk është vështirë të shihet angazhimi i tij i madh në jetën mendore dhe në jetën publike shqiptare, ndërsa prej botimeve me karakter historik dhe dokumentar nuk është vështirë të shihet se si ai i ka tejkaluar synimet e projektuara në projektet e tij të lexuara dhe të botuara në fund të viteve '60 dhe '70.

Vepra e tij Çështja shqiptare - historia dhe politika (1994), është modeli më i mirë i një vepri të shkruar me mbështetje të pazakonshme dokumentare, me koncepte dhe diskurs intelektual, që deri më tash i ka munguar historiografisë shqiptare, prandaj nuk është e rastit që kjo vepër në të njëjtën kohë ju shërbeu institucioneve diplomatike ndërkombëtare, atyre që një dekadë më vonë do t'iu shërbejë edhe Profesor Qosja si pjesëtar i delegacioneve shqiptare. Po kështu mund të thuhet për veprën tjetër Nezašticasudbina: O Albancima u Jugoslavijanas (1990), botuar në Zagreb, për t'u ribotuar e plotësuar me tekste të tjera në Prishtinë me titull, Populli i ndaluar (1990), me të cilën mori pjesë aktive në zhvillim historike të viteve '80, duke mbrojtur kudo historinë, identitetin dhe kulturën shqiptare, në të vërtetë, sikur shprehej në njërin prej intervistave, fjala është për albanologjinë. Me tekstet polemizuese, reflektive, sprovat, intervistat dhe diskutimet e tjera, të botuara në këto vëllime, Profesor Qosja krahas pak intelektualëve kroatë, slovenë, serbë, boshnjakë e shqiptarë, bëri të mundur dejugosllavizimin e mendimit shqiptar dhe të popujve të tjerë të kësaj perandorie të Evropës Qendrore e Juglindore. Mision të tillë patën edhe veprat e tjera polemizuese e dokumentare edhe në vitet e dekadat në vijim, deri në rënien e ish-Jugosllavisë dhe më pastaj gjatë ndërtimit të shtetësisë së Kosovës, mendja paravajtëse dhe roli i të cilit nuk mungoi asnjëherë. (VIJON)

Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (12)

ADN-ja e fushave magnetike dhe antimagnetike



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Të gjitha protonet, elektronet dhe neutronet kur ndodhen në rrethana të caktuara e ndërrojnë nivelin energjetik të tyre dhe kalojnë në vetërigjenerator të mikrogrimcave (', '''), ('', ''') dhe ('', ''')...etj. Të gjitha këto mikrogrimca që burojnë nga grimcat e lartpërmendura posedojnë një ADN të caktuar.

AND-ja e fushës magnetike të tokës

Bazuar në rezultatet eksperimentale në rastet kur polet e një magneti mbulohen me pllaka të hekurit, tani në rastin e tokës na paraqiten njëkohësisht dy fusha: 1. Fusha magnetike sekondare (ADN-së) e tokës e cila buron nga polet e

polet e magnetit, buron jashtë poleve të magnetit. Këtë fushë e formojnë mikrogrimcat përkatësisht dipolet magnetike ('), ('') dhe (''). Ngjashëm sikur te fusha magnetike sekondare ((ADN-së) edhe dipolet e fushës antimagnetike në brendinë e tyre përmbajnë nga dy fusha të cilat qarkullojnë në drejtime të kundërta, kurse posedojnë një nivele energjetik shumë here më të lartë se sa dipolet e fushës magnetike sekondare.

Fusha magnetike dhe antimagnetike e tokës

Duke mos u ndalur në këtë rast te fusha e cikloneve dhe tornados elektromagnetike themi se nga planeti i tokës burojnë dy fusha njëkohësisht, ku njëra është magnetike sekondare kurse e tjetra fusha antimagnetike. Prandaj, edhe nga toka cila sikur është sqaruar më parë, nga shtresa e materialeve feromagnetike që ndodhet mbi polet e magnetit të tokës buron fusha magnetike sekondare e tokës (FST).




Figura 16

Kurse dipolet magnetike sekondare (") burojnë nga poli i dytë (")2) magnetik i tokës, i cili tani quhet poli magnetik i jugut (S). Gjithashtu nga këto dipole magnetike sekondare burojnë njëkohësisht nga dy flukse të fushave magnetike (") dhe ("), të cilat gjithashtu kanë intensitete të ndryshme, ku për dallim nda rasti i mëparshëm tani vlera e fluksit të fushës magnetike (")> ("), si dhe lëvizin në kahje (drejtim) të kundërt. Mikrogrimcat e fushës magnetike sekondare ('), ('') dhe ('') kanë nivel më të lartë energjetik se mikrogrimcat ("), (") dhe (").

fushës antimagnetike nuk mund të ndalohen për shkak të nivelit energjetik të protoneve, elektroneve dhe neutroneve që kanë marrë me rastin e formimit të shtresave të materialeve feromagnetike mbi polet magnetike të tokës. Në këtë mënyrë rreth planetit të tokës, dhe kundër forcës tërheqëse të ciklonit dhe tornados elektromagnetike, dhunshëm janë shpërndarë tri fusha të ndryshme, duke filluar nga fusha magnetike primare e tokës, fusha magnetike sekondare e tokës si dhe fusha antimagnetike e tokës. Kurse për shkak të këtyre forcave këto tri fusha marrin formën e sferave rreth tokës. Mirëpo meqenëse kemi një ndryshim të niveleve energjetike në mes mikrogrimcave të fushës magnetike primare, mikrogrimcave të fushës magnetike sekondare si dhe mikrogrimcave të fushës antimagnetike, rreth tokës formohen pesë sfera me rreze të ndryshme.

a) R1- Sfera e fushës sekondare magnetike e tokës (SBs) e cila ka rreze më të vogël për shkak se ka nivel energjetik më të ulët të mikrogrimcave ("), (") dhe ("), kjo sferë e fushës sekondare magnetike e tokës(Bs) sot njihet sikur magnetosfera e tokës.

b) R2- Sfera e fushës magnetike primare (SBp) e cila ka buruar drejtpërdrejt së drejti nga polet e tornados elektromagnetike (1) dhe (2). Mikrogrimcat (, () dhe () e këtyre dipoleve magnetike kanë nivel energjetik tejet të lartë, dhe shumë të rrezikshme për jetën e njeriut, si dhe formojnë rrezen mesatare nga sipërfaqja e tokës.


c) R3-Sfera e fushës antimagnetike të tokës (SBa) e cila ka një rreze shumë here më të madhe se sa rrezja e fushës magnetike primare dhe sekondare të tokës, për shkak se nivelit më të lartë të mikrogrimcave ('), ('') dhe ('') të fushës antimagnetike, në këtë rast sfera e fushës antimagnetike të tokës ka rreze shumë here më të madhe se rrezja e fushës magnetike primare dhe magnetosferës së tokës. d) R4- Sfera e ciklonit të tokës (aX+aY) e cila ka një rreze shumë të madhe nga qendra e tokës, dhe është sfera e parë që është formuar. e) R5- rrezja e tornados elektromagnetike të tokës (aX+aZ) e cila ka një rreze të njëjtë me rrezen e ciklonit të tokës. Shiko figurën 17.

Forma sferike e trupave qiellorë rreth të cilëve rrotullohen trupa të tjerë qiellorë

Cikloni dhe tornadoja elektromagnetike janë dy fenomene që ju japin formë sferike të gjithë trupave qiellorë rreth të cilëve rrotullohen trupa të tjerë qiellorë. Prandaj ç'do trup qiellorë që ka një formë të rregullt gjeometrike përkatësisht sferike në brendësinë e tij ka aktive këto dy fenomene, pa marrë parasysh nivelin energjetik të tyre. a) Sikur një trup qiellorë do ta kishte në brendinë e tij vetëm fenomenin e ciklonit, ai do të zgjatej në drejtim të boshtit (x) ashtu sikur shihet në figurën 18. a). b) Sikur një trup qiellorë do ta kishte në brendinë e tij vetëm fenomenin e tornados elektromagnetike, ai do të zgjatej në drejtim të boshtit (x) ashtu sikur shihet në figurën 18. b). Por pa marrë parasysh se trupi qiellor posedon apo jo fushë magnetike, forma e tij sferike tregon qartë që fenomeni i tornados elektromagnetike është prezent, por nuk ka aftësi prodhimi të fushës magnetike dhe antimagnetike. (VIJON)

R5	(aX+aY)
R4	(aX+aZ)
R3	(β'δ'μ')
R2	(β δ μ)
R1	(β''δ''μ'')

Fig17



magnetit (1) dhe (2) si dhe 2. Fusha antimagnetike ((ADN-ja) që buron jashtë poleve të magnetit (1) dhe (2). Fusha magnetike e cila buron nga polet e magnetit (1) dhe (2) është një fushë magnetike sekondare (ADN-së) të cilën e formojnë mikrogrimcat sekondare, përkatësisht dipolet magnetike sekondare ("), (") dhe ("). Këto dipole magnetike sekondare përmbajnë në brendinë e tyre nga dy fusha magnetike që lëvizin në drejtime të kundërta, kurse kanë një nivel energjetik shumë here me të vogël se sa grimcat nga të cilat kanë buruar. Fusha antimagnetike (ADN-ja) për dallim nga fusha magnetike sekondare (ADN-së) e cila buron nga shtresa e materialeve feromagnetike që ndodhen mbi

Pasi tani kemi të bëjmë me një fushë magnetike simetrike e cila buron në të dy polet e magnetit të tokës, themi se gjithashtu se kjo fushë magnetike simetrike përbëhet nga dipolet magnetike sekondare (") dhe ("), të cilat burojnë nga të dy polet magnetike të tokës. Shiko figurën 16. Dipolet magnetike sekondare (") së bashku me mikrogrimcat sekondare (") burojnë nga poli i parë magnetik i tokës (1") i cili në rastin e tanishëm quhet poli magnetik i veriut (N). Nga këto dipole magnetike sekondare burojnë njëkohësisht nga dy flukse të fushave magnetike (") dhe ("), të cilat kanë intensitete të ndryshme me ç'rast (") > ("), si dhe që lëvizin në kahje(drejtime) të kundërta.

Veprimi i ciklonit dhe tornados mbi fushën magnetike dhe antimagnetike të tokës

Veprimi i ciklonit dhe tornados në planetin e tokës janë forca tërheqëse prej periferisë në drejtim të qendrës, ku forca e ciklonit të tokës njihet sikur forca gravitacionale e tokës. Në këtë mënyrë sikur fusha magnetike ashtu edhe fusha antimagnetike e tokës i nënshtrohen forcës tërheqëse të ciklonit dhe tornados elektromagnetike. Prandaj, forca tërheqëse e këtyre fenomeneve ka drejtim të kundërt me fushën magnetike dhe antimagnetike. Këto dy fenomene pasi kanë drejtime të kundërta me fushën magnetike dhe antimagnetike të tokës, tentojnë që mos t'i lejojnë këto fusha të burojnë nga polet magnetike, por edhe mos shpërndahen nga toka. Kurse pasi fenomenet e vetërigjenerimit të fushave, oftoftë të fushës magnetike apo




fig 18a



Fig18a

E rrallë

Një grua vdes në Australi në konkursin e ngrënies së ëmbëlsirave

Një grua humbi jetën në Australi derisa po merrte pjesë në një konkurs të ngrënies së ëmbëlsirave. Gruaja, 60 vjeçe, raportohet se ka pasur një komplikim gjatë aktivitetit që u mbajt të dielën në një hotel në Hervey Bay, Queensland, për ta shënuar Ditën e Australisë. Garuesit ishin filmuar më parë me ngrënie të



lamingtons, një tortë tradicionale si sfungjer e mbuluar me çokolatë dhe anë kokosi. Asaj iu dha ndihma e parë në vendngjarje dhe më pas u dërgua në spital, ku edhe vdiq më vonë.

FOTO E DITES



Policia paraushtarake shihet me maska në fytyrë duke bërë roje në portën Tiananmen në Pekin. /AP/

E rrallë

Propozohet formula ideale e kafesë

Më pak kafe dhe më pak e imët, e përgatitur me më pak ujë. Kjo është receta ideale për të pasur kafën ekspres më të mirë, formulë e botuar në revistën "Matter" nga një grup prej 10 kimistësh dhe matematikanësh nga pesë vende, të udhëhequr nga Jamie Foster nga Universiteti britanik i Portsmouthit. Pika fillestare e studimit



është se edhe nëse bëhet në të njëjtën mënyrë, kafja ekspres ndryshon.

BARSOLETA E DITËS



Nxënës të shkollës fillore po ecnin rugës, kur papritmas shohin një çift të sapomartuarish duke dalë nga kisha. Një nga fëmijët më çapkën u thotë shokëve:

- Ja çfarë është paniku. I afrohet dhëndrit, e kap për dore dhe i thotë: - Tung babi!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj
Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Sektori financiar ju mbështet. Nga ana tjetër, dashuria si çift ëmbëlsion ditët tuaja. Takimet e reja premtojnë të jenë të ngrohta dhe shumë pasionante.</p>	 <p>DEMI Do të keni shumë rëndësi në grupin tuaj shoqëror. Sektori i punës gjithashtu fiton pikë.</p>	 <p>BINJAKËT Do të keni një punë sfiduese, por të kënaqshme, nëse ju bëheni sa më shumë krijues dhe të gjithë këtë krijimtari ta vini në funksion të biznesit tuaj.</p>	 <p>GAFORRJA Do të krijoni miqësi dhe kontakte. Një konferencë apo shfaqje televizive zgjeron horizontin tuaj drejt interesave të reja.</p>	 <p>LUANI Me këtë kombinim të rrallë dhe të paçmuar ju do të jeni fitues si në punë ashtu edhe në dashuri.</p>	 <p>IRGJËRESHA Planetet do t'ju prishen dhe do të bëni gjëra që nuk ju tërheqin. Për të qenë më prodhimtar, duhet ta shmangni çdo shpërqendrim.</p>
 <p>PESHORJA Mos u emociononi shumë për një shaka, të një kolegu ose një bashkëpunëtor. Praktikoni sportin tuaj të preferuar për të nxjerrë jashtë energjitë tuaja të tepërta.</p>	 <p>AKREPI Dita e sotme paralajmëron plot surpriza, por edhe me mundësi stimuluese profesionale.</p>	 <p>SHIGJETARI Do të përballeni me përplasje në shtëpi dhe në zyrë, keqtrajtime gjatë udhëtimeve dhe grindjeve me ata që do t'ju japin ide të kota.</p>	 <p>BRICJAPI Të nxitur nga yjet, do të jeni aktiv dhe ndërmarrës! Sido që të jetë aktiviteti që do të kryeni, i pavarur ose i varur, do të jeni në gjendje t'i pohoni mendimet tuaja pa lënë pas dore sjelljet e mira.</p>	 <p>UJORI Dëgjoni zërin e arsyes, i cili sigurisht nuk ju mashtron. Marsi zhvendos vëmendjen drejt fizikut dhe mirëqenies.</p>	 <p>PESHQIT Një lajm i mirë ju pret në punë, nëse keni një veprimtari të vetëpunësuar. Hëna, Venera, Neptuni dhe Jupiteri po ndizen si një kometë dhe do të jenë të gatshëm për t'ju shërbyer në raste të arta.</p>

Georgina Rodriguez zbret në Sanremo dhe shkon në hotel me tre yje



Edhe Georgina Rodriguez do të jetë në Sanremo, në skenën e Aristonit. Konfirmimi fotografik vjen në orët e fundit ku Georgina shfaqet në krah në

Amadeus. Rodriguez nuk ka mundur t'i sjellë fat Cristiano Ronaldos së saj, duke mos qenë e pranishme në tribunën e Napoli - Juventus.



Dua Lipa na tregon pamje nga klipi i ri

Këngëtarja shqiptare Dua Lipa është duke përgatitur projektin e ri. Pas suksesit që arriti me 'Dont start now', tani Dua Lipa është duke përgatitur një tjetër projekt të cilin do ta publikojë në fund të këtij muaji. Këngëtarja ndau

edhe disa skena nga klipi i ri i cili do ta mbajë titullin 'Physical'. Kjo këngë do të jetë vetëm fillimi i një kapitulli të ri, pasi Dua gjatë muajve të ardhshëm do ta lansojë edhe albumin e ri 'Future nostalgia'.

Irina Shayk flet pas ndarjes me Bradley Cooperin



Përkundër faktit se marrëdhënia e tyre nuk funksionoi, Irina Shayk ende ndihet "shumë me fat" që ka qenë në lidhje me Bradley Cooper. Në numrin e ri të revistës "British Vogue", modeluesja 34-vjeçare, e cila u

nda nga Cooperi, 45-vjeçar, pas katër vjetësh bëri disa komente të rralla dhe reflektuese për marrëdhënien e tyre. "Unë mendoj se kemi qenë shumë me fat që e përjetuam atë që kishim me njëri-tjetrin", i ka thënë Shayk revistës.

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
 KUVENDI KOMUNAL - MALISHEVË
 QKMF "Dr. SHPËTIM ROBAJ" në Malishevë
 Nr. Prot. 44
 Datë 28.01.2020

Drejtori i QKMF-së "Dr. Shpëtim Robaj" në Malishevë, në bazë të Rekomandimit nr.07/11 dt.15.01.2020 të drejtorit të Shëndetsisë dhe MS në Malishevë, nenit 8 të ligjit të punës nr.03/L-212 si dhe nenit 4 të udhëzimit administrative nr.7/2017, për rregullimin e procedurave për konkurs në sektorin public; për plotsimin e vendeve të punës publikon këtë:

KONKURS PUBLIK

**I. 1(nje) Farmacist ne Barnatore ne QKMF Malishevë:
 Niveli I Pages:7.20**

Detyrat e punës:

Organizon,koordinon dhe mbikëqyre punët ne Depo dhe Farmaci.
 Kontrollon preparatet dhe barërat qe gjinden në Depo,afatet dhe llojet e barërave etj.
 Mbikëqyre punën e infermierit farmaceutik.
 Në bashkëpunim me Kryeinfermierin e QKMF-së propozon asgjësimin e barërave dhe preparateve me afat të skaduar.
 Kryen punë tjera te parapara me ligje.
 Për punën e vetë I përgjigjet Drejtorit të QKMF-së.

Kushtet e konkursit:

-Te jetë farmacist i diplomuar
 -Të ketë provojë punë një(1) vjeçare.

Dokumentet e nevojshme:

-Licencën e punës,
 -Kopjen e Diplomes
 -Certifikatën e lindjes,
 -Certifikatën e Mjekut
 -Certifikatën që nuk është nënë hetime .

-Kohëzgjatja kontratës: në kohë të pa caktuar (pas periudhës provuese tre mujore).
 -Orët javore të punës 40.
 Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjete te informimit , aplikacionet e arritura pas afatit nuk pranohen , aplikacionet me dokumenta të pa kompletuara nuk shqyrtohen. dokumentacioni dorëzohet në zyrën e personelit të QKMF-së.

Drejtori
 Dr.Nuhi Morina -sp. Mediater

Shkolla e Mesme e Profesionale
 "Ymer Prizreni" Prizren

Kosovë 20000 Prizren rr.Bajram Curri p.n
 Nr.tel.038/20035377
 e-mail:mgavazaj@hotmail.com

Nr.protokoli-55/2020

Në bazë të Rregullorës nr.01/2017,datë 02.02.2017, Ligjit NR.04/L-143, nenit 12 për Arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës , Drejtori i Shkollës së Mesme Ekonomike "Ymer Prizreni" në Prizren, vendos për pranimin e nxënësve në arsimin për të rritur dhe me këtë rast publikon këtë:

KONKURS

EKONOMI
 1.Kontabilitet..... 1 paralel 32 nxënës
 2.Tregti me pakicë e shumicë..... 1 paralel 32 nxënës

TEKNOLOGJI USHQIMORE
 1.Teknologji ushqimore.....1 paralel 32 nxënës

JURIDIK
 1.Asistent juridik..... 1 paralel 32 nxënës

Kushtet:
 Dokumentacioni (dëftesa e shkollimit paraprak,certifikata e lindjes, dhe letërnjoftimi i fotokopjuar).
 Paga bëhet sipas rregullores së MASHT-it Nr.11/2011 Dt.:30.12.2011 dhe Rregullores për tarifa,taksa,ngarkesa dhe gjoba nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale nr.01/11.

1. Për regjistrimin e vitit për një klasë: 100 €
 2. Praktika profesionale 50 €
 3. Lënda me shkrim dhe me gojë 10 €
 4. Lënda me gojë 8€
 5. Për provim përfundimtar (certifikatë): 30€
 6. Për diplomë(përfundimi i shkollimit): 50€
 7. Provime diferenciale 10€

Vijueshmëria në mësim
 Kandidatët e pranuar janë të obliguar që t'i ndjekin 18 javë mësimi nëse klasa e profilit përkatës numëron mbi 15 nxënës, dhe në fund t'i nënshtrohen testit vlerësues në të gjitha lëndët e parapara për arsimin për të rritur.
 Për klasë ku numri i nxënësve është nën 15 nxënës, organizohet mësimi konsultativ.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në gazetë.



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

'Dardanët' e futsallit fotografohen me cigare, pritet dënimi

Lojtarët e Përfaqësueses së Kosovës në fut-sall janë fotografuar në Aeroportin "Adem Jashari" duke pirë cigare. Ky veprim mund t'u kushtojë me dënim nga Federata e Futbollit të Kosovës

PRISHTINË, 28 JANAR - Përfaqësuesja e Kosovës në fut-sall të martën është nisur për në Gjeorgji, ku do të marrë pjesë në rundin e parë kualifikues për Kampionatin Evropian të Futsallit "Euro 2022". Lojtarët e futsallit, të cilët janë grumbulluar për këtë raund kualifikues, janë parë duke konsumuar cigare në ambientet e Aeroportit "Adem Jashari". Lidhur me këtë sjellje të lojtarëve të Përfaqësueses në fut-sall, sekretari i përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës, Eroll Salihu, ka thënë se është një gjest i pahijshëm, por se federata nuk mund t'ua ndalojë futbollistëve pirjen e duhanit. "Me të vërtetë është një gjë e pahijshme. Nuk është në rregull aspak. Lojtarët që prezantojnë Kosovën e

që kanë të veshur fanellën e Kosovës assesi nuk lejohet të pinë duhan në vendet publike. Është totalisht e patolerueshme, mirëpo ne nuk mund t'ua ndalojmë atyre duhanin në jetën e tyre private", ka thënë Salihu për "Kosovapress". Sa i përket një dënimi të mundshëm për futbollistët të cilët u panë duke pirë duhan, Salihu deklaroi se duhet të bisedohet me përzgjedhësin e Kosovës, Ramadan Cimitin, më pas të vendoset për një gjë të tillë. Në këto kualifikime "dardanët" e futsallit do t'i luajnë tri ndeshje kundër Austrisë më 29 janar, në orën 16:00, kundër Gjermanisë, më 30 janar, po në orën 16:00 dhe kundër Gjeorgjisë, më 2 shkurt, në orën 22:00.




Shoqata e Futbollistëve ia dorëzon 12 007 euro portierit Arben Beqiri

MITROVICË, 28 JANAR - Kryetari i Shoqatës për Mbrojtjen e të Drejtave të Futbollistëve, Visar Zogiani dhe anëtari i Bordit, Behar Maliqi, e kanë vizituar portierin e diagnostifikuar me tumor në lukth, Arben Beqirin. Me këtë rast, Zogiani dhe Maliqi ia dorëzuan mjetet e grumbulluara nga futbollistët, kryetari i FFK-së, Agim Ademi, nënkryetari Bakir Burri dhe nga shumë njerëz të tjerë të vullnetit të mirë dhe humanitarë. "Përveç dëshirës që kishim për ta takuar, ne me këtë vizitë e informuam Arbenin për mjetet e grumbulluara financiare dhe ia dorëzuam gjithsej 12 007.25 . Mjetet financiare iu transferuan përmes xhironlogarisë bankare. Këto mjete u



mblodhën nga shumë futbollistë të klubeve të Superligës së Kosovës, FFK-ja, kryetari i FFK-së, Agim Ademi, nënkryetari Bakir Burri dhe nga shumë njerëz të tjerë të vullnetit të mirë dhe humanitarë. Arbeni shprehu mirënjohje të thellë për këtë

përkrahje dhe falënderoi nga zemra secilin kontribuues", thuhet në njoftimin e Shoqatës së Futbollistëve. Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Futbollistëve të Kosovës po ashtu ka njoftuar se përkrahja për Arbenin nuk do të ndalet.



Burnley, 28 milionë euro për Muriqin

BURNLEY, 28 JANAR - Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, është një nga lojtarët më të lakmuar nga skuadrat evropiane. E fundit që i shtohet garës për transferimin e tij është skuadra e Burnleyt, e cila është gati të ofrojë 28 milionë

euro. Lajmin e ka bërë të ditur mediumi turk "Milliyet". Në anën tjetër Fenerbahçe nuk është e interesuar ta shesë Muriqin deri në afatin kalimtar të verës, por kjo nuk po pengon skuadrat e mëdha që ta kërkojnë Muriqin.

Igumanoviqi, përforcimi i madh i Lirisë

PRIZREN, 28 JANAR - Skuadra e Lirisë është përforcuar me Blazho Igumanoviq, i cili luan në pozitën e mbrojtësit të majtë. Ai ka një karrierë të begatshme me skuadrat malazeze si: Zeta, Rudar, Sutjeska, Titograd dhe, së fundi, Buduqnost. Po ashtu, ka luaj-

tur dhe në Kazakistan (Astana), ku ka dalë kampion, pastaj në Poloni (Zavish) e Bullgari (Montana). Igumanoviq ka qenë edhe pjesë e kombëtares malazeze për 24 herë radhazi. Ndërsa në vitin 2013 ishte zgjedhur lojtar i vitit në shtetin fqinj. Gjatë karrierës në klubet

malazeze ka fituar dy tituj kampioni dhe dy Kupa. "Jam i kënaqur me kushtet, pritjen e bashkëlojtarëve. Jasmini (Jasmin Muhoviq, lojtar aktual i Lirisë) më ka folur shumë mirë për njerëzit, qytetin dhe gjithçka. Pres që të kemi sa më shumë sukses. Ftoj tifozët që

bashkërisht ta arrijmë suksesin drejt Superligës. Këtë e meriton ky qytet i bukur", ka thënë Igumanoviq. Ndërsa trajneri i Lirisë, Skënder Shengyli, ka deklaruar: "Besojmë në përvojën e tij të madhe. Liria mund të përfitojë shumë nga angazhimi tij".



Kosova 3x3 në kualifikimet e FIBA Europe Cup

PRISHTINË, 28 JANAR - Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) ka marrë vendim që ta mbështesë Përfaqësuesen e Kosovës 3x3 në garat ndërkombëtare që do të ketë në vitin 2020. Kosova 3x3 vitin e kaluar kishte debutuar në kualifikimet e FIBA Europe Cup, ku ishte në grup me Slloveninë dhe Andorrën (1 humbje dhe 1 fitore). Pas debutimit historik, Përfaqësuesja e Kosovës 3x3 do të jetë pjesëmarrëse edhe në kualifikimet e FIBA Europe Cup për vitin 2020. Këto kualifikime

do të mbahen në Konstanca të Rumanisë. Garat kualifikuese do të zhvillohen më 23-24 maj në Rumani. Përveç Kosovës në këto kualifikime janë edhe Rumania, Bjellorusia, Zvicra, Republika e Çekisë, Sllovakia, Suedia, Austria, Greqia, Andorra,

Kroacia, Bullgaria, Maqedonia Veriore dhe San Marino. Grupet do të përbëhen me tri ose katër skuadra. Fituesi i grupit do të kualifikohet në gjysmëfinale e më pas finalja. Fituesi do të kualifikohet në FIBA 3x3 Europe Cup, ku garat do të zhvillohen

më 25-27 qershor në Antwerpen të Belgjikës.



më 25-27 qershor në Antwerpen të Belgjikës.

Rahoveci i motivuar nga Liga Ballkanike kërkon fitore ndaj Bashkimit

PRISHTINË, 28 JANAR - Në mesjavë do të zhvillohet xhironja e 23-të e Superligës së Kosovës në basketboll. Derbi i kësaj xhiro do të zhvillohet të mërkurën në Rahovec, ku "Vreshtarët" e presin Bashkimin. Rahoveci është lider i renditjes me 35 pikë apo 15 fitore dhe pesë humbje, kurse Bashkimi ndodhet në vendin e pestë me 31 pikë ose 12 fitore dhe shtatë humbje. Takimi në palestrën "Mizahir Isma" pritet të jetë shumë interesant.



Sfida e parë e javës së 23-të do të zhvillohet në mes të Ponte Prizrenit dhe Trepçës. Prizrenasit kanë 12 fitore dhe tetë humbje, derisa mitrovicasit katër fitore dhe 13 humbje. Të enjten Peja e pret Lipjanin në një ballafaqim ku pejanët shihen favoritë, por fitorja e vështirë në fundjavë ndaj Feronikelit do të bëjë që verdhezinjtë të jenë më

të kujdesshëm. Peja ka 11 fitore dhe tetë humbje, derisa Lipjani një fitore dhe 19 humbje. Ndashja e fundit do të zhvillohet mes Sigal Prishtinës dhe Feronikelit. Prishtinasit nga 19 ndeshje kanë 14 fitore dhe pesë humbje, derisa skuadra nga Drenasi ka pesë fitore dhe 15 humbje nga 20 përballje në Superligë.

SUPERLIGA - JAVA 23

Të mërkurën takohen:
17:00 Ponte Prizreni - Trepça
19:00 Rahoveci - Bashkimi

Të enjten takohen:
17:00 Peja - Lipjani
19:00 Sigal Prishtina - Feronikeli
Golden Eagle Ylli (pushon)

Gordoni shënon 50 pikë në fitoren e Houstonit

HOUSTON, 28 JANAR - U zhvilluan gjashtë sfidat e radhës në NBA dhe rezultati ndoshta më i paparashikueshëm ishte ai i përballjes së "Salt Lake City" mes vendësve të Utah Jazzit dhe Houston Rocketsit. Edhe pse skuadra teksane kishte udhëtuar në këtë transfertë pa dy "yjet" e saj, James Harden dhe Russell Westbrook, sërish arriti të triumfojë falë të papërmbajtshmit Eric Gordon, autor i 50 pikëve, që është dhe rekordi i pikëve të shënuara prej tij në një ndeshje. 126-117 ishte rezultati përfundimtar i këtij takimi, çka bëri të pavlefshme paraqitjet e dy basketbollistëve vendës, Mitchel e Bogdanoviq, që shënuan 36 respektivisht 30 pikë. Në përplasjen tjetër të madhe të Perëndimit, Dallas Mavericksi triumfoi përballë Oklahoma City Thunderit me rezultatin 107-97.



Vendimtar Luka Donçiq me 29 pikë, 11 "rebounde" e 5 asiste. Thunderi në njëfarë mënyrë vuajti shumë mungesën e Chris Paulit. Duke u spostuar në Lindje, Cleveland Cavaliersi fitoi në shtëpinë e Detroit Pistonsit, 110-115, i udhëhequr nga Collin Sexton dhe Kevin Love, autorë të 23 dhe 20 pikëve. Miami Heat kaloi pa shumë probleme, në derbin e Floridas, Orlando Magic, me rezultatin 113-92, falë "triple double" të Bam Adebayo (20 pikë, 10 "rebounde" e 10 asistime). Fund drithëruer në takimin në mes të Chicago Bullsit dhe San Antonio Spursit. Dy gjuajtje të lira të real-

izuara nga Zach LaVine u dhanë epërsinë prej dy pikësh 110-108 Bullsave. Dy të qindtat e sekondës para rënies së sirenës për përfundimin e ndeshjes, DeMar DeRozan pëson faull dhe fiton dy gjuajtje të lira, por realizon vetëm një prej tyre, me fitoren që i mbeti Chicago Bulls me vetëm një pikë diferencë, 110-109. 42 pikët e shënuara nga Buddy Hield ndihmuan Sacramento Kingsin të fitojë në kohën shtesë 129-133 në parketin e Minnesota Timberwolvesit. Për vendësit nuk shërbyen për asgjë 36 pikë, 9 "rebounde" dhe 8 asistime të Bradley Wigginsit.

SHKURT

Më 31 janar mbahet seminari për licencim të klubeve

Federata e Futbollit të Kosovës ka njoftuar se më 31 janar në orën 10:00 sektori i licencimit i kësaj federate do të mbajë seminar për klube në kuadër të procesit të licencimit për garat ndërkombëtare të UEFA-s për edicionin 2020/21. Ky seminar do të mbahet në sallën e konferencave në selinë e FFK-së.

Napoli, pas Rrahmanit, arrin marrëveshje edhe me Kumbullën

Skuadra e Napolit synon ta përfortojë mbrojtjen dhe për këtë ka arritur marrëveshje me Veronan për mbrojtësin shqiptar Marash Kumbulla. Shuma e marrëveshjes është 20 milionë euro, plus 4 milionë euro të tjera në formë bonusesh. Pas Hysajt dhe Rrahmanit, Kumbulla do të jetë shqiptari i tretë në Napoli. Marrëveshja pritet të finalizohet shumë shpejt dhe Kumbulla do t'i bashkohet Napolit në qershor.

Erikseni edhe zyrtarisht në Inter

Christian Eriksen edhe zyrtarisht është lojtar i Interit. Mesfushori danez i kreu testet mjekësore të hënën, kurse zyrtarizimi i tij është bërë sot për 20 milionë euro. 27-vjeçari vazhdimisht ishte lidhur me një transferim në Real Madrid ose Manchester United, por në fund mesfushori vendosi për Interin, duke nënshkruar një kontratë katërvjeçare e gjysmë dhe do të paguhet 11 milionë euro. Interi në këtë afat kalimtar ka nënshkruar edhe me Ashley Young (Manchester United) dhe Victor Moses (Chelsea).

LeBron, Bryantit: Të dua vëllai im i madh

Aksidenti fatal me helikopter që i mori jetën Kobe Bryantit, vajzës së tij 13-vjeçare dhe shtatë personave të tjerë, ka tronditur botën e sportit dhe jo vetëm. Mesazhet për Bryantin kanë qenë të shumta jo vetëm nga sportistët, por thuajse nga të gjithë. Ai që ende nuk kishte reaguar ishte një nga miqtë e tij më të mirë, LeBron James. Nëpërmjet një postimi në "Instagram", James shkruan se do të kujdeset për trashëgiminë e tij të Lakersat. "Nuk jam ende gati, por ja ku filloj. Jam ulur këtu, duke u përpjekur për të shkruar diçka në këtë postim, por sa herë mendoj për ty, për Xhixhin, miqësinë dhe vëllazërinë që na bashkonte nis të qaj! E dëgjova zërin tënd të dielën në mëngjes pata se ta lija Filadelfian për t'u kthyer në Los Anxhelos. Nuk mund ta mendoja për miliona vjet se ajo do të ishte biseda jonë e fundit. Si drejtin?! Të dua vëllai im i madh. Zemra ime do jetë te Vanesa dhe fëmijët! Do doja të thosha shumë për ne të dy këtu... ne të Lakers. Të premtoj se do ta marr mbi shpatulla trashëgiminë tënde dhe premtoj të vazhdoj atë që ke bërë. Më jep forcë nga atje lart dhe kujdesu për mua në këtë mision. Unë do të kujdesem për 'Ne' këtu. Ka edhe shumë gjëra që do të doja të thosha por, nuk mundem, nuk mundem të vazhdoj! Deri kur të takohemi përsëri vëlla", ka shkruar LeBron.

Joshua: Ja kush e fiton revanshin mes Furyt dhe Wilderit

Boksieri britanik Anthony Joshua, kampion bote në peshën e rëndë në kategoritë IBF, WBA dhe WBO, ka folur sot në lidhje me duelin e dytë mes Deontay Wilder dhe Tyron Fury. Kjo sfidë mes dy boksierëve të pamposhtur do të zhvillohet më 22 shkurt në Las Vegas. Sfida është një revansh për Fury, pas barazimit në duelin e parë mes tyre, në dhjetor të 2018-s. Wilder në këtë sfidë do ta mbrojë titullin kampion bote në peshën e rëndë, në kategorinë WBC. "Unë besoj se Fury do ta fitojë këtë sfidë, më duket një njeri i ri, i rilindur. Fury ka zhvilluar disa duele të qeta kohët e fundit dhe është gati për këtë përballje. Tani ai e di se si ta mundë Wilderin. Ndërsa amerikani e ka kuptuar se ndaj Furyt nuk do të mjaftojë vetëm një grusht, siç ndodhi ndaj Ortizit. Tyson Fury është një boksier shumë i mirë dhe për këtë duel është më i qetë psikologjikisht se Wilderi. Nëse kjo sfidë shkon me 12 raunde, besoj se Fury do të fitojë këtë herë", ka deklaruar Joshua.

REZULTATET

Cleveland Cavaliers - Detroit Pistons	115-110
Orlando Magic - Miami Heat	92-113
Sacramento Kings - Minnesota Timberwolves	133-129
San Antonio Spurs - Chicago Bulls	109-110
Houston Rockets - Utah Jazz	126-117
Dallas Mavericks - OKC Thunder	107-97



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenin 6 pika 5 dhe nenin 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të tje Dhenave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, *Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:*

Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Titulli i punës:	Intervistues dhe mbikëqyrës për të realizuar intervistat për Anketën TIK 2020 dhe SILC 2020
Numri i referencës:	ASK-DSS-001
Tarifa e shërbimit:	I negociuar
Raporton te:	Mbikëqyrësit e Anketës TIK dhe SILC/Njësia e standardit jetësor, ASK
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta-(MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Deri në gjashtë (6) muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	ASK-37 (30 anketues dhe 7 mbikëqyrës)

Detyrat e mbikëqyrësit

- Të marrin pjesë në trajnime dhe të njihen me udhëzimet metodologjike dhe organizative përfshirë pyetësorin e ekonomisë familjare dhe pyetësorin individual dhe të jenë të përgatitur për të praktikuar në terren bazuar në udhëzimet për anketën TIK dhe SILC;
- Siguron intervistuesit me udhëzime të qarta dhe të sakta për punën në terren;
- Pajiset me tabletë dhe listat e ekonomive familjare për Qarqet nën përgjegjësi për (TIK dhe SILC);
- Merr pjesë në procesin e rishpërndarjes së njësive të mostrës (listat fizike) në mesin e intervistuesve, sa herë që është e nevojshme;
- Monitoron punën në terren;
- Monitoron për çdo ditë rregullisht intervistuesit;
- Kontrollon dhe llogarit punën e intervistuesve brenda intervaleve të caktuara;
- Kontrollon anketat e zhvilluara me metodën CAPI të plotësuar në mënyrën elektronike nga terreni në baza ditore dhe siguron që intervistuesit kanë përfillur udhëzimet për punë;
- Ndihmon në problemet nga terreni që lidhen me zbatimin e metodologjisë;
- Kontakton intervistuesit nëse zbulohet ndonjë parregullsi;
- Përditëson bazën e të dhënave të mostrës me informacione të reja nga terreni, (në lidhje me gjetjen e informatave të ndryshme në teren, krahasuar me të dhënat në listën fizike ekzistuese), në bashkëpunim me ekipin e TIK dhe SILC dhe një specialist IT;
- Të bëjnë raportimin ditor në zyrën qendrore;
- Të përfundojnë sipas afatit Anketa e TIK dhe SILC;
- Të mbajë të gjitha informatat e pranuar në familjet e anketuara si sekret zyrtar;
- Të kthejë pajisjet e pranuar nga ASK (tabletë), pas përfundimit të punës në teren.

Përgatitja shkollore për mbikëqyrës /përvoja:

- Të kenë të përfunduara ndonjë nga fakultetet (obligative),
- Kandidatët me përgatitje më të lartë shkollore, kanë përparësi;
- Përvojat në anketa të ndryshme në terren, kanë përparësi;
- Përvojat në mbikëqyrjen e anketave në terren, kanë përparësi;
- Përvoja në punë ekipore në rolin e mbikëqyrjes, kanë përparësi;
- Kandidatët të cilët kanë lejen e vozitjes kanë përparësi;

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi shumë të mirë për të komunikuar dhe bashkëpunuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Të kenë aftësi të mira organizative dhe të kenë njohuri në përdorimin e kodeve të hartave për identifikimin e objekteve të banimit;
- Të jenë të gatshëm të punojnë sipas nevojës me orar pune më të gjatë, përfshirë fundjavat.

Detyrat dhe përgjegjësitë e anketuesit

- Të marrin pjesë në trajnime dhe të njihen me udhëzimet metodologjike dhe organizative përfshirë pyetësorin e ekonomisë familjare dhe pyetësorin individual dhe të jenë të përgatitur për të praktikuar në terren bazuar në udhëzimet për anketën TIK dhe SILC;
- Të zhvillojë grumbullimin e të dhënave për anketën e TIK dhe SILC me metodologjinë CAPI (tabletë).
- Të bëjë identifikimin e ekonomisë familjare duke u bazuar në listat e ekonomive familjare dhe në harta si dhe të respektohet kriteri për individët për moshën 16 deri 74 vjeç për anketën TIK ndërsa për anketën SILC të respektohet kriteri për të gjithë individët e ekonomisë familjare dhe duke intervistuar të gjithë anëtarët që plotësojnë kriterin për moshën (16 vjeç e më shumë të plotësorin pyetësorin individual);

- Të respektoj udhëzimet e pyetësorit për pyetjet që nuk duhet t'i parashtrihen disa të anketuarve dhe të respektojnë të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkruara në udhëzime;
- Para largimit nga ekonomia familjare, obligohen të kontrollojnë pyetësorin elektronik të plotësuar për t'u siguruar se të gjitha pyetjet janë plotësuar dhe të gjitha udhëzimet janë ndjekur;
- Të vizitoj përsëri për të intervistuar ekonomitë familjare/ individët të cilët nuk mund të intervistohen gjatë vizitës së parë;
- Identifikimi i adresave dhe kodeve në hartë të cilat janë të përcaktuara në qarqet regjistruese dhe ekonomitë familjare në anketën TIK dhe SILC;
- Përdorimi i koordinatave për gjetjen e adresave të ekonomive familjare të intervistuar në vitin 2019 që janë përzgjedhur për ri-intervistim dhe përdorimi i adresave dhe hartave për Qarqet Regjistruese dhe ekonomitë familjare të caktuara në valën e tretë SILC 2020;
- Të njoftoj mbikëqyrësin për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe të kërkohet ndihmë nëse është e nevojshme;
- Intervista të zhvillohet në gjuhën të cilën i përket komunitetit të cilin është përzgjedhur për intervistim.
- Të bëjnë raportimin ditor të mbikëqyrësi;
- Të përfundojnë sipas afatit Anketa e TIK dhe SILC ;
- Të mbajë të gjitha informatat e pranuar në familjet e anketuara si sekret zyrtar.
- Të kthejë pajisjet e pranuar nga ASK (tabletë), pas përfundimit të punës në teren.

Përgatitja shkollore për anketues/përvoja:

- Të kenë të kryer së paku shkollën e mesme;
- Të kenë përvojë pune, e preferuar përvoja në anketa;
- Të kenë përvojë në përdorimin e teknologjisë informative (laptopëve / tabletave);
- Përparësi kanë personat që kanë ndjekur kurse të teknologjisë informative apo që kanë marrë pjesë së paku në një anketë.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi shumë të mirë për të komunikuar dhe bashkëpunuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Të kenë aftësi të mira organizative dhe të kenë njohuri në përdorimin e kodeve të hartave për identifikimin e objekteve të banimit;
- Të jetë nga rajoni përkatës ku do të zhvillohet anketa e TIK dhe SILC;
- Të jenë të gatshëm të punojnë sipas nevojës me orar pune më të gjatë, përfshirë fundjavat.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit në media dhe web faqen e ASK-së.

Numri i mbikëqyrësve sipas regjioneve:

Regjioni	Mbikëqyrës
Gjakovë	1
Gjilan	1
Mitrovicë	1
Pejë	1
Prizren	1
Prishtinë	1
Ferizaj	1
Total	7

Numri i anketuesve sipas etnitetit dhe regjionit:

Regjioni	Anketues Shqiptar	Anketues Serb	Anketues: Boshnjak, Turk dhe të tjerë
Gjakovë	3	/	/
Gjilan	3	1	/
Mitrovicë	3	/	/
Pejë	3	/	/
Prizren	4	/	2
Prishtinë	6	1	/
Ferizaj	3	1	/
Total	25	3	2

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-së, ose mund të shkarkohen nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr."Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: CV¹, kopja e letërnjoftimit, dokumenti mbi vendbanimin, diploma e fakultetit për pozitën mbikëqyrës ndërsa diploma e shkollës së mesme për pozitën anketues (të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje). Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen intervistës me gojë. Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 200 31 149 apo 038-200 31 151 prej orës 08:00 – 16: 00.

¹ Përfshirë: Nr. Telefoni si dhe një adresë elektronike



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agjencia za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Na osnovu člana 8. stava 3.1, člana 6, stava 5 i člana 33 Zakona br.04 / Z-036 o Zvaničnoj Statistici Republike Kosovo, Administrativnog Uputstva br.08 / 2012 o Uslovima i Načinu Pružanja Statističkih Podataka Dobijenim Posebnom Obradom Zvaničnih Statistika i člana 12 stava 4 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova, Zakona br. 04 / Z-077 o Obligacionim Odnosima, Agjencia za Statistiku Kosova, raspisuje:

Javni Konkurs o Sporazumu za Posebne Usluge

Naziv institucije:	Agjencia za Statistiku Kosova
Naziv pozicije:	Anketar/ispitivač i supervizor za sprovođenje Ankete IKT-a 2020 i SILC 2020
Referentni broj:	ASK-OSS-001
Tarifa usluga:	Po dogovoru
Izveštava:	Supervizoru Ankete IKT-a i SILC-a/ Jedinica Životnog Standarda ASK-a
Vrsta ugovora:	Sporazum za Posebne Usluge–(SPU)
Trajanje ugovora:	Do šest (6) meseci
Radno vreme:	Puno
Lokacija i broj izvršilaca:	ASK-37 (30 anketara i 7 supervizora)

Zadaci supervizora:

- Učestvuje u obuci i upoznaje se sa Metodološkim i Organizacionim Uputstvima uključujući i Uputnika za domaćinstva i za pojedince, i bude spreman/na da primeni znanja na terenu na osnovu uputstva za Anketu IKT-a i SILC-a;
- Pružta anketarima jasna i tačna uputstva o radu na terenu;
- Da bude opremljen tablet računom i spiskom domaćinstva za popisne krugove pod njegovu odgovornost (IKT i SILC);
- Učestvuju u redistribuciji jedinica uzorka (fizičkih spisaka) među anketarima, kad god je to potrebno;
- Prati rad na terenu;
- Redovno svakodnevno prati rad anketara;
- Proverava i izračunava rad anketara u okviru dogovorenih intervala;
- Svakodnevno proverava ankete sprovedene CAPI metodom koja su svakodnevno elektronski popunjena sa terena i osigurava da anketari slede radna uputstva;
- Pomaže u rešavanju problema koji se odnose na primenu metodologije;
- Kontaktira anketare ako se otkriju nepravilnosti;
- Ažurira bazu podataka uzorka novim informacijama sa terena (u vezi pronalazača informacija na terenu koja se razlikuju sa podacima u postojećem fizičkom spisku) u saradnji sa IKT-a i SILC-a i stručnjakom IT-a;
- Svakodnevno izveštava centralnoj kancelariji;
- Završi u predviđenom roku Anketu IKT-a i SILC-a;
- Čuva sve dobijene podatke dobijene u anketiranim domaćinstvima kao službenu tajnu;
- Vrati opremu primljenu od ASK (tablet računar) nakon završetka rada na terenu.

Školska sprema za supervizora/iskustvo:

- Završen bilo koji fakultet (obavezno);
- Prednost imaju kandidati koji su završili viši nivo obrazovanja;
- Iskustvo u raznim anketama na terenu, ima prednost;
- Iskustvo u nadgledanju anketara na terenu, ima prednost;
- Iskustvo u timskom radu u ulozi supervizora, ima prednost;
- Kandidati koji imaju vozačku dozvolu, imaju prednost.

Kompetencije i veštine:

- Dobre veštine komunikacije i saradnje;
- Spremnost za timski rad;
- Dobre organizacione veštine i znanje u upotrebi kodova mapa za identifikaciju stambenih zgrada;
- Spreman/na da po potrebi radi sa dužim radnim vremenom, uključujući i vikendom.

Zadaci i odgovornosti anketara:

- Učestvuje u obuci i upoznaje se sa Metodološkim i Organizacionim Uputstvima uključujući i Uputnika za domaćinstva i za pojedince, i bude spreman/na da primeni znanja na terenu na osnovu uputstva za Anketu IKT-a i SILC-a;
- Prikuplja podatke za Anketu IKT-a i SILC-a metodom CAPI (Tablet računom).
- Identifikuje domaćinstva na osnovu liste domaćinstava i mapa, kao i poštuje kriterijum za osobe starosti 16 do 74 godina za anketu IKT-a, dok za anketu SILC-a da poštuje kriterijum anketiranja svih članova domaćinstva koji ispunjavaju kriterijum starosti (16 i više godina da popune individualni upitnik);
- Poštuje uputstva upitnika za pitanja koja ne treba postavljati nekim ispitanicima i prati sve procedure i objašnjenja navedena u uputstvima;

- Pre napuštanja domaćinstva kontroliše popunjeni elektronski upitnik da se osigura da su popunjeni svi odgovori na pitanja iz upitnika i sva uputstva praćena.
- Poseti ponovo domaćinstva radi intervjuisanja ispitanika koje nije bilo moguće intervjuisati tokom prve posete;
- Identifikuje adrese i kodove na mapi koji su navedeni u popisnim krugovima i domaćinstvima u Anketi IKT-a i SILC-a;
- Korišćenje koordinata za pronalazače adresa domaćinstava intervjuisanih 2019. godine koja su odabrana za ponovo intervjuisanje i korišćenje adresa i mapa za Popisne Krugove i domaćinstva označena u trećem talasu SILC 2020;
- Obavesti supervizora o mogućim problemima i neizvesnostima i traži pomoć ako je potrebno;
- Intervjuisanje se sprovodi na jeziku zajednice kojoj pripada ispitanik;
- Dnevno izveštava svom supervizoru;
- Anketa IKT-a i SILC-a da se završi u predviđenom roku;
- Sve dobijene podatke u anketiranim domaćinstvima treba da čuva kao službenu tajnu.
- Vrati opremu primljenu od ASK-a (tablet računar) nakon završetka rada na terenu.

Školska sprema za anketara/iskustvo:

- Najmanje završena srednja škola.
- Radno iskustvo, poželjno iskustvo u anketama;
- Iskustvo u korišćenju informacione tehnologije (laptopa / tablet računara);
- Prednost imaju osobe koje su pohađale kurseve informacione tehnologije ili koji su učestvovali u najmanje jednoj anketi.

Kompetencije i veštine:

- Veoma dobru saradnju i komunikacione veštine;
- Spreman/na za timski rad;
- Dobre organizacione veštine i znanje u upotrebi kodova mapa za identifikaciju stambenih zgrada;
- Da bude iz odgovarajućeg regiona gde će biti sprovedena Anкета IKT-a i SILC-a.
- Spreman/na da po potrebi radi sa dužim radnim vremenom, uključujući i vikendom.

Uslovi učešća na konkursu:

Pravo učešća na konkurs imaju svi punoletni (stariji od 18.godina) Građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

Konkurs je otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima i na veb- stranici ASK-a.

Broj supervizora prema regionu:

Region	Supervizori
Đakovica	1
Gnjilane	1
Mitrovica	1
Peć	1
Prizren	1
Priština	1
Uroševac	1
Ukupno	7

Broj anketara prema etničkoj pripadnosti i regionu:

Region	Anketari-Albanci	Anketari-Srbi	Anketari- Bošnjaci, Turci i drugi
Đakovica	3	/	/
Gnjilane	3	1	/
Mitrovica	3	/	/
Peć	3	/	/
Prizren	4	/	2
Priština	6	1	/
Uroševac	3	1	/
Ukupno	25	3	2

Podnošenje prijave:

Obrasci za prijavu mogu se dobiti U Arhivi ASK-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice ASK-a: <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacije se dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova, Ul."Zenel Salihu" br.4, Priština.

Uz aplikaciju potrebno je priložiti: CV¹, kopiju lične karte, dokumenat o prebivalištu, diplomu fakulteta za poziciju supervizora, i diplomu srednje škole za poziciju anketara, (svi dokumenti treba da budu kopije).

Nepotpune prijave i one *podnete* nakon isteka roka *neće* biti prihvaćene.

Zbog velikog broja primljenih prijava, samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani.

Kandidati koji uđu u uži izbor biće intervjuisani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju Osoblja na broj telefona: : 038- 200 31 149 ili 038-200 31 151 od 08:00 – 16: 00 časova.

¹ Uključujući: Broj telefona i elektronsku adresu



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrena	
Pranuar me dt.	24.01.2020
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-10

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren - Kosovë; Tel: +381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. _____ Datë: ___/___/____

Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren shpall:

KONKURS
PËR ANGAZHIMIN E PERSONELIT AKADEMIK NË BAZË TË NEVOJAVE TË NJËSIVE
AKADEMIKE

Angazhimi me honorar i personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Statutin e Universitetit "Ukshin Hoti", Ligjin e Punës së Republikës së Kosovës nr. 03/L-212, UA/07/2017 dhe në Rregulloret e Brendshme të Universitetit.

a) Kushtet e përgjithshme për angazhim

- Personeli i jashtëm akademik mund të angazhohet në Universitet për një periudhë të caktuar kohore, me qëllim të realizimit të veprimtarisë arsimore e shkencore mbi bazën e një konkursi publik për bashkëpunëtorë të jashtëm (me honorar). Angazhimi nuk nënkupton sipas këtij konkursi themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës e as pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
- Angazhimi me honorar i bashkëpunëtorëve të jashtëm bëhet në mënyrë transparente në përputhje me Rregulloren për Procedurat Vlerësuese për Angazhimin e Bashkëpunëtorëve të Jashtëm.

b) Fondi i orëve mbinormë (honorar), dhe kohëzgjatja e kontratës

- Sipas Rregullos nr. 01-11/A të datës 18.01.2019, bashkëpunëtorët e jashtëm, të angazhuar, dhe profesorët jashtë Universitetit, por me tituj të barazvlefshëm në Universitete publike, për ligjerata mund të mbajnë deri në gjashtë orë në javë. Në veçanti për ligjeruesit e angazhuar në gjuhën turke dhe boshnjake të cilët mund t'i mbajnë deri në tetë orë në javë.

Bashkëpunëtorët e angazhuar për ushtrime, (pa thirrje akademike në Universitetet Publike) mund të mbajnë deri në tetë orë në javë.

- Kandidatët të cilët do të përzgjidhen në kuadër të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie dhe ushtrime, do të pajisen me kontrata pune me honorar (varësisht nga fondit i orëve që kanë), për periudhën nga 16.02. 2020 – 31.05. 2020.

- Kompensimi do të bëhet në përputhje me raportin e orëve të realizuara gjatë semestrit të caktuar, i cili vërtetohet nga njësia akademike përkatëse, por jo më shumë se fondit i orëve i përcaktuar sipas rregullos në fuqi për të ardhurat personale të Personelit Akademik të Universitetit. Kompensimi bëhet vetëm nga kategoria ekonomike paga dhe medijet.

- Personeli i angazhuar që ka thirrje akademike si: Profesorë i rregullt, Profesorë i asociuar, Profesorë asistent dhe Ligjërues, përveç orëve të ligjëratarave të mbajtura, i kompensohen edhe orët e ushtrimeve në raport 2:1 (2 orë ushtrime = 1 orë ligjëratarë), në kuadër të normës së paraparë.

- Në kuadër të kontratës me honorar është përfshirë edhe mbajtja e provimeve dhe angazhimet e tjera, si: konsultimet me studentë, dhe mbajtja provime në tri afate të rregullta dhe deri në dy afate të jashtëzakonshme (nëse i lejon Senati, afatet e jashtëzakonshme).

- Të gjitha kontratat e përkohshme të angazhimit me honorar do të jenë të bazuara në dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti", Ligjin e Punës së Republikës së Kosovës nr. 03/L-212 dhe Aktet e Brendshme të Universitetit.

- Një mësimdhënës mund të angazhohet në dy ose më shumë lëndë të së njëjtës fushë në njësitet akademike, duke mos e tejkaluar normën e plotë.

c) Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kërkesa për aplikim dhe CV-ja;
- Çertifikata apo ekstrakti i lindjes;
- Çertifikata penale (vërtetim nga gjykata mbi të kaluarën penale);
- Kopja e diplomës përkatëse e noterizuar nga organi kompetent, (kandidatët që kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin edhe vendimin e nostrifikimit të diplomës përkatëse si: bachelor, master, magistraturë, dhe doktoraturë);
- Kandidatët të cilët aplikojnë për pozitën e asistentit, lektorit apo korepetitorit, duhet të sjellin edhe certifikatën e notave të studimeve bachelor dhe master;
- Dëshmi për publikime shkencore e profesionale, si dhe informata të tjera specifike shtesë;
- Dëshmi për angazhime në Universitet (nëse kanë qenë të angazhuar më parë) ose në ndonjë institucion tjetër (të akredituar) të arsimit të lartë;
- Kandidatët që nuk kanë shtetësi të Republikës së Kosovës, duhet të sjellin dëshminë e lejeqëndrimit. Nëse nuk kanë qëndrim rezident në Republikën e Kosovës, të sjellin një deklaratë nën betim që nuk janë banorë rezident në Republikën e Kosovës.
- Dëshmia për njohjen e gjuhëve të huaja, (njohja e gjuhës angleze ose e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi).
- Stafi i rregullt Akademik i Universiteteve Publike në Republikën e Kosovës të cilët shprehin interesin për angazhim sipas këtij konkursi përveç dokumentacionit të përmendur më lart, duhet të sjellin edhe leje ose konfirmim nga ana e Rektorit të Universitetit prej nga vijnë si dhe dëshminë për vlerësimin e performancës së kandidatit nga institucioni akademik (Universiteti, kolegji) ku ka punuar paraprakisht.

I) FAKULTETI I EKONOMISË

- Një profesor për lëndën: Anglishtja Afariste II (2 orë).
- Një profesor për lëndën: Gjuha Gjermane II (2 orë).
- Një profesor për lëndën: Gjuha Turke II (2 orë).
- Një profesor për lëndën: Gjuha Turke III (2 orë).
- Një asistent për lëndën: Anglishtja Afariste II (2 orë).
- Një profesor për lëndën: Gjuha Gjermane II (2 orë).
- Një profesor për lëndën: Gjuha Turke II (2 orë).
- Një profesor për lëndën: Gjuha Turke III (3 orë).

II) FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

a) Në gjuhën turke:

- Një mësimdhënës për lëndët: Teknologjia TCP/IP, Cloud Computing, Përmbajtja dinamike e ueb-inxhinjeringut (sem. IV-O, sem .VI-O, sem. VI).
- Një mësimdhënës për lëndët: Mikrokontrollerët, Autentifikim dhe kriptografi (sem. IV-O, sem IV-O).
- Një mësimdhënës për lëndën: Konceptet e telekomunikimit mobil (sem- VI-O).
- Një mësimdhënës për lëndën: Anglisht për shkencat kompjuterike 4 (sem. VI-Z).
- Një mësimdhënës për lëndën: Metodat e hulumtimit (sem. IV-O).
- Një mësimdhënës për lëndën: Ndërveprimi njeri-kompjuter (sem. VI-Z).
- Tre asistent: Për grup lëndësh.

b) Në gjuhën boshnjake:

- Një mësimdhënës për lëndët: Mikrokontrollerët, Konceptet e Telekomunikimit Mobil (sem. IV-O, sem .VI-O).
- Një mësimdhënës për lëndët: Autentifikim dhe Kriptografi, Cloud Computing (sem. IV-O, L+U, sem. VI-O).
- Një mësimdhënës për lëndët: Teknologjia TCP/IP, Ueb-Dizajn, Përmbajtja Dinamike e Ueb-inxhinjeringut (Sem IV-O, Sem IV-O, Sem VI-O).
- Një mësimdhënës për lëndën: Anglisht për Shkencat Kompjuterike 4 (sem. VI-Z).
- Një mësimdhënës për lëndën: Metodat e Hulumtimit (Sem VI-O).
- Një mësimdhënës për lëndën: Ndërveprimi Njeri-Kompjuter (TIT Sem IV-Z).
- Tre asistent: Për grup lëndësh.

III) FAKULTETI I JURIDIKUT

- Një asistent për lëndën: E Drejta e Procedurës Penale II (8 orë).
- Një asistent për lëndën: E Drejta Penale II (8 orë).
- Një asistent për lëndën: Politikat dhe Administrata Publike, Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese (2 orë).
- Një asistent për lëndën: E Drejta Civile, pjesa e posaqme (E Drejta Sendore) (8 orë).

IV) FAKULTETI I EDUKIMIT

a) Në gjuhën mësimore shqipe:

- Një mësimdhënës për lëndët: Metodologjia e Mësimin të Matematikës I, Programi (Fillor) O, Metodologji e Njohjes së Koncepteve Matematikore, Programi (Parashkollor) (O).
- Një mësimdhënës për lëndën: Metodologji e Arteve Figurative, Programi (Parashkollor) O.
- Një mësimdhënës për lëndën: Metodologji e Leximit Letrar, Programi (Parashkollor)Z.
- Një asistent për lëndët: Edukimi Gjithëpërfshirës me Metodologji Programi (Fillor) O, Bazat e Hulumtimit në Edukim (Fillor-Parashkollor) (O), Filozofi e Edukimit, (Parashkollor) O.
- Një asistent për lëndët: Psikologji Edukimi Programi (Fillor) O, Psikologji e Zhvillimit dhe e Personalitetit (Parashkollor) (Z).
- Një asistent për lëndën: Letrsi për Fëmijë Programi (Fillor) O.

b) Në gjuhën mësimore turke:

- Një mësimdhënës për lëndën: Bazat e Shkencave Natyrore me Metodologji (O)
- Një mësimdhënës për lëndën: Artet Figurative me Metodologji (O)
- Një mësimdhënës për lëndën: Pedagogjike (Z)
- Dy mësimdhënës për lëndën: Psikologjike (O dhe Z)
- Një mësimdhënës për lëndën: Bazat e Shkencave Shoqërore me Metodologji (O)
- Një mësimdhënës për lëndën: Historia Kombëtare (O)
- Një mësimdhënës për lëndën: Edukimi Mjedisor (Fillor dhe Parashkollor) (O)
- Një mësimdhënës për lëndën: Metodologji e Leximit Letrar, (Parashkollor) (Z)

C) Në gjuhën mësimore boshnjake:

- Një mësimdhënës për lëndën: Strategjitë dhe Metodat e Shkrim Leximit, Programi Fillor O).
- Një mësimdhënës për lëndët: Letërsi për fëmijë, Programi Fillor (O), Estetikë, Programi (Parashkollor) (Z).
- Një mësimdhënës për lëndën: Metodika e Mësimin të Matematikës I, Programi Fillor (O).
- Një mësimdhënës për lëndën: Metodologji e Njohjes së Koncepteve, Matematikore, Programi (Parashkollor) (O).
- Një mësimdhënës për lëndën: Filozofia e Edukimit, Programi Parashkollor (O).
- Një mësimdhënës për lëndën: Bazat e Shkencave Shoqërore me Metodologji, Programi (Parashkollor) (O).
- Një mësimdhënës për lëndën: Historia Kombëtare Programi Fillor (O)
- Një mësimdhënës për lëndët: Artet e Bukura Programi Parashkollor (Z), Artet e Bukura Programi (Fillor) (Z), Punë Dore me Modelim, Programi Parashkollor (O).
- Një mësimdhënës për lëndën: Praktika Pedagogjike II (5 javë), P. Parashkollor (O).
- Një mësimdhënës për lëndën: Praktika Pedagogjike II (5 javë), Programi Fillor (O).
- Një mësimdhënës për lëndën: Gjuhë Angleze për Mësues Programi Fillor (Z).

V) FAKULTETI I FILOLOGJISË

a) Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe:

- Një mësimdhënës për lëndën: Gjuhë angleze IV.
- Një asistent për lëndët e letërsisë: Letërsi Romantike II, dhe Letërsi Moderne II.

b) Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze:

- Një mësimdhënës për lëndën: Sintaksë e Gjuhës Angleze.
- Një mësimdhënës për lëndën: Përkthim Anglisht-Shqip.

3. Një mësues për lëndën: Vlerësimi dhe testet.
4. Një asistent për lëndët: ESP I, dhe EAP I.
5. Një asistent për lëndën: Historia e Gjuhës Angleze.
6. Një asistent për lëndën: Poezi e Renesancës.

c) Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane:

1. Një mësues për lëndët: Letërsi Gjermane III, Seminar në Shkencën e Letërsisë Gjermane (6 orë).
2. Një mësues për lëndët: Sintaksë e Gjuhës Gjermane, dhe Hyrje në Didaktikën e Gjuhëve të Huaja (6 orë).
3. Një asistent për lëndët: Praktikë Gjuhe IV, dhe Gjuhë e Sotme Gjermane, (6 orë U).

Dokumentacioni dorëzohet në kopje fizike në Fakultetet përkatëse nga ora 09:00 deri në orën 15:00, në objektet e Universitetit "Ukshin Hoti", adresa: "Rruga e Shkronjave", nr. 1, 20000 Prizren. Të drejtë aplikimi, pa asnjë diskriminim, kanë të gjithë kandidatët e interesuar, të cilët i plotësojnë kriteret për aplikim. Nuk mund të aplikojnë kandidatët që kanë arritur moshën e pensionit sipas dispozitave ligjore në fuqi ose që e arrijnë këtë moshë para datës, 16.02.2020.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e publikimit në faqen e Universitetit respektivisht deri më, 07.02.2020, kurse publikimi i listave bëhet në faqen zyrtare të Universitetit "Ukshin Hoti" (www.uni-prizren.com) më, 12.02.2020.

Afati i ankesave bëhet nga data, 13.02.2020 - 17.02.2020 (deri në orën 15:00). Ankesat bëhen në Njësitë Akademike përkatëse dhe i drejtohen komisionit të formuar nga Këshilli i Fakultetit. Për hapat tjerë të procedurës pala informohet me shkrim në fomë të këshillës juridike.

Vërejtje: Lëndët janë të specifikuar, si: **obligative (O)**, dhe **zgjedhore (Z)**.

Të gjitha ato lëndë zgjedhore, për të cilat nuk plotësohet numri minimal i studentëve për formimin e grupeve sipas Rregullores, do të anulohen, prandaj Universiteti "Ukshin Hoti" paraprakisht u bënë të ditur kandidatëve se përzgjedhja e tyre për lëndë zgjedhore nuk nënkupton doemos angazhimin e tyre për këtë semestër.

Njësitë Akademike dalin me njoftime zyrtare rreth lëndëve zgjedhore.


Rektor
Prof. asoc. dr Ismet Temaj

